


KOHA

për

Gjate..



Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Gender Studies Center

Beteja e dyfishtë e grave për përfaqësim dhe vendimmarrje politike

Rexhep Maloku

Gratë përballen me sfida të dyfish-ta krahasuar me burrat kur vjen puna te gara zgjedhore për të marrë timonin e posteve politike dhe vendimmarrëse në Kosovë. Dhe kjo ndodh për një mal arsyesh të lidhura me mungesën e një kulture politike të barazisë gjinore, por edhe sherri i paragjykimeve shoqërore që janë të rrënjosura thellësisht dhe që ndikojnë në sfera të tjera shoqërore - edhe në një vend demokratik e ku barazia gjinore garantohet me kushtetutë. Por, forca e zakonit është më e madhe në një shoqëri që megjithatë aspiron anëtarësimin në Bashkimin Evropian, krahun ekzekutiv të të cilit e udhëheq gjermanja Ursula von der Leyen, ndërkaq estonezja Kaja Kallas ka timonin e politikës së jashtme dhe të sigurisë së bllokut politik, që po sfidaohet seriozisht prej luftës në Ukrainë dhe krisjes së madhe të rendit botëror prej shteteve të fuqishme që udhëhiqen prej burrave.

Qasja e presidentes Vjosa Osmani në politikën e jashtme të Kosovës dhe droja e kryeministrit Albin Kurti se ka mbetur nën hije të saj, sidomos në raport me Perëndimin, kanë ndikuar pjesërisht në vendimin e Lëvizjes Vetëvendosje që t’ia kthejë shpinën aleates së dikurshme dhe të mos ia zotojë mbështetjen për ta kërkuar edhe një mandat presidencial, kanë thënë burime të mirëinformuara me rrjedhat e fundit politike në vend.

Hapësirë e dominuar nga burrat

Natyra Kuçi, e cila ka qenë pjesë e garave zgjedhore lokale e qendrore, thotë se sigurisht që problemet me të cilat ballafaqohen gratë dallojnë thellësisht prej atyre të burrave. Ajo pohon se gratë janë më pak të pranishme në hapësirën publike, në diskutimet mbi politikën, dhe - duke iu referuar zgjedhjeve parlamentare të vitit 2019, kur edhe vetë ishte pjesë e garës - “janë më pak prezente si kandidate potenciale në zgjedhje”.

“Hapësira politike është e dominuar nga burrat dhe për gratë është betejë e dyfishtë sa herë që vendosin të marrin pjesë në politikë. Fillimisht, të luftojnë e t’i tejkalojnë paragjykimet patriarkale që rëndojnë mbi to, e së dyti t’i bindin qytetarët për vlerat politike e politikat konkrete që ti, si kandidate e një subjekti, i shtyn përpara dhe dëshiron t’i implementosh në Kuvend e në Qeveri”, thekson Kuçi, që garoi me PSD-në.

Sociologu Kushtrim Bekteshi thekson se përkundër ndryshimeve pozitive në emancipimin dhe përfshirjen e grave në jetën politike, prapëseprapë problematike mbetet përfshirja politike dhe sidomos mënyra e vendimmarrjes në pozita publike. “Kemi parë jo rrallë paragjykime, stereotipa e gjuhë thellësisht të papranueshme brenda spektrit politik e jashtë tij për gjininë femërore dhe angazhimin e tyre publik. Një tjetër dimension gjithashtu problematik mbetet edhe mentaliteti me premisa të theksuara patriarkale, i cili vërehet në diskursin e përditshëm publik e politik. Pra, në këtë sens gratë në Kosovë ende hasin në barriera që ua vështirësojnë atyre angazhimin dhe kontributin politik”.

Sipas të dhënave të organizatës jo-qeveritare KDI, në legjislaturën e tashme, 79 janë burra dhe 41 gra, përfshirë kryetaren Albulena Haxhiu. LVV-ja i ka 21 gra deputete, PDK-ja 7, LDK-ja 5, AAK-ja 2, komuniteti serb 3 dhe 3 syresh komunitetet e tjera.

Pasi Komisioni Evropian më 4 nëntor 2025 publikoi Raportin e vendit për Kosovën, organizata QIKA vlerësoi se numri i madh i kritikave dhe problemeve të ngritura në raport tregon se mbetet shumë punë për t’u bërë për barazinë gjinore. “Barazia



gjinore nuk është çështje e izoluar; ajo është parakusht për çdo zhvillim politik dhe ekonomik, përfshirë integrimin evropian. Pa adresuar pabarazinë gjinore dhe pa garantuar zbatimin e ligjeve në praktikë, Kosova nuk mund të avancojë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian”, ka shkruar QIKA në reagimin e saj në faqen zyrtare të organizatës. “Qëndrimet patriarkale dhe stereotipat gjinorë të rrënjosur thellë vazhdojnë të pengojnë përparimin drejt barazisë”.

Dallimet ndërmjet garës lokale dhe asaj qendrore

Janina Ymeri nuk ia doli të merrte mjaftueshëm vota që të bëhej pjesë e Kuvendit Komunal të Ferizajt në zgjedhjet e 12 tetorit, por në parlamentaret e 28 dhjetorit 2025 mori besimin në nivelin kombëtar që të bëhej pjesë e Kuvendit të Kosovës, pa u mbështetur në përfaqësimin e detyrueshëm gjinor ligjor prej 30 për qind. Ymeri e ka mësuar nga përvoja se për zgjedhje lokale kandidatura duhet të shpallet shumë kohë para afatit zyrtar. “Periudha zyrtare prej një muaji është tejet e shkurtër për këtë lloj angazhimi. Një tjetër specifikë dhe vështirësi është rrethi familjar; pasja e një rrethi të vogël të bën kandidat me bazë më të kufizuar votuesish”, ka thënë ajo, duke shtuar se investimi financiar në fushatë është pjesë e rëndësishme. Sipas saj, në zgjedhjet parlamentare elektorati i targetuar është më i shpërndarë, porse përparësi është mundësia për fushatë të përbashkët me disa kolegë dhe hapësirën më të madhe mediatike, sidomos kur ndjek një kauzë specifike, siç bëri ajo pasi u mor

pothuajse ekskluzivisht me çështjen e blerjes së energjisë elektrike.

Kuçi iu përvesh vjet garës për kryetare të Deçanit, ku mori 11.88 për qind të votave. Nga përvoja si asambleiste lokale dhe kandidate për deputete spikat dinamika të ndryshme ndërmjet dy niveleve. “Përjetimi im personal si grua në fushatën lokale është pak më ndryshe. Tek unë dhe fushata që e udhëheqja njerëzit e dëgjuan një zë që po e flet të vërtetën, po ofron alternativa për qeverisje më të mirë e të drejtë dhe nuk po dorëzohet. Këto i përjetuan, besoj, pavarësisht që jam grua. Në momentin që ke vullnet politik, vendosmëri e vetëmohim, ide të qarta dhe konkrete sesi një gjë të caktuar e trajton, ia zgjidh problemin dhe implementon projektin tënd për të, njerëzit do të të dëgjojnë. Kjo ka ndodhur në Deçan dhe është arsyeja pse fushata e jonë ka marrë mbështetjen që e ka marrë”. Fushata e Kuçit rroku vëmendjen e mediave qendrore, ku asaj iu dha hapësirë për ta shpalosur programin. “Gratë duhet të jenë çdo herë e më shumë prezente në hapësirën publike, në studio televizive e kudo tjetër”.

“Studiot televizive të burrave”

Remzie Shahini-Hoxhaj, ligjëruese në Departamentin e Gazetarisë dhe njëherësh prodekane e Fakultetit Filologjik të Universitetit “Hasan Prishtina”, thotë se kandidatët burra kanë pakrahasimisht hapësirë më të madhe në debate televizive se gratë. “Kjo është një prej formave më perfide që e hesht zërin e grave në jetën publike”, thekson ajo, duke treguar se hapësira mediatike nuk është rritur për gratë pavarësisht rritjes së num-

rit të grave kandidate për kryetare në zgjedhjet lokale më 2021 dhe 2025. “Kjo është një formë për t’i dekurajuar gratë, duke iu dhënë mundësinë e kinse ‘përfaqësimit’, duke i prezantuar vetëm disa në numër shumë të mangët dhe jo të gjitha, edhe duke përmbushur kuotën gjinore me personat e njëjtë për të gjitha temat”. Hulumtimet e saj tregojnë se grave nuk u jepej hapësirë e barabartë diskutimi dhe iu ndërpritej fjala. “Kjo formë e komunikimit i bën ato të ndihen dhe të duken më joprofesionale në krahasim me burrat, duke insistuar për ta marrë fjalën”. Ajo ka spikatur mungesën e ftesës në disa debate televizive për kandidaten e vetme grua për kryetare të Prishtinës, Besa Shahinin, nga PSD, gjë që ia ka minuar relevancën në skenën politike.

Getoarë Mulliqi, nga Rrjeti i Grave Gazetare të Kosovës, që përfaqëson gazetaret dhe punonjëset e mediave në Kosovë, thotë se kandidateve për poste politike nuk u jepet hapësirë e barabartë e përfaqësimit në media. “Burrat vazhdojnë të dominojnë hapësirat analitike dhe debatet politike, sidomos në mediat qendrore. Për më tepër, gratë paragjykohen më shumë në baza personale sesa profesionale, dhe kjo i afekton njëjtë të gjitha gratë aktive publikisht, si kandidatet (politikanet), si gazetaret, ashtu edhe aktivistët. Këtë e konfirmojnë edhe monitorimet e proceseve zgjedhore: në debatet televizive gjatë fushatës parlamentare të fundit, pjesëmarrja e grave ka qenë vetëm rreth 21%, ndërsa burrat përbënin afro 79%. Edhe në raportimet informative, vetëm rreth 16% e kronikave zgjedhore kanë përfshirë gra kandidate dhe koha televizive e dedikuar për to ka qenë dukshëm më e ulët. Pra, jo vetëm që gratë shfaqen

më rrallë, por edhe kur shfaqen, hapësira dhe pesha e tyre në diskurs mbetet më e kufizuar”.

Ajo ka treguar se 65 për qind e anëtarëve të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës janë gazetarë. Gratë gazetarë përherë bartin barrën më të madhe të raportimit nga terreni. Sidomos gjatë fushatave dhe ditës së zgjedhjeve, derisa moderatorët dhe analistët burra mblidhen mbrëmjeve nëpër studio televizive, duke analizuar mbi informacionet që gazetaret i raportojnë nga terreni.

Diskriminimi që i frenon gratë

Mulliqi thotë se gratë hezitojnë të bëhen pjesë e paneleve televizive, sepse të dhënat tregojnë se niveli i debatit nuk është i kënaqshëm saqë gratë të binden të marrin pjesë. “Në qarqe të mbyllura dominojnë narrativa të llojit ‘gratë në jetën publike janë më të afta që të mbulojnë tema më të lehta, apo sociale’, por si përfundim kjo është mburojë nga realiteti i krijuar pa zërin dhe përfaqësimin e denjë të 50 për qind të popullsisë. Pra, mund të konkludojmë se kjo nuk është domosdoshmërisht rezultat i një vendimi të drejtpërdrejtë diskriminues, por pasojë e strukturave të brendshme mediatike dhe perceptimeve të rrënjosura mbi ‘autoritetin’ në analizën politike”.

“Kjo sa është prodhim i një mendësie të tejkaluar, është formë e fshehur e shovinizmit ku gratë nuk merren seriozisht për atë çka thonë, ose synohet të prezantohen si të tilla”, alarmon Shahini-Hoxhaj. Sidomos këto ‘Reels-at’ i shoh si shumë të rrezikshme në kontekstin gjinor, sepse synohet që sidomos ato çka thonë gratë të nxirren nga konteksti dhe pastaj të bëhen virale dhe objekt talljeje”.

Mulliqi ngulmon se kur hapësira është e pabarabartë kjo ndikon drejtpërdrejt edhe në besueshmërinë dhe pranimin e grave si lidere. “Për më tepër, gratë që janë aktive publikisht shpesh përballen me sulme personale dhe gjuhë të urrejtjes”.

“Pabarazia gjinore është fundamentalisht e lidhur me dimensionin kulturor dhe përfshin aspekte edhe përtej jetës institucionale, por të cilat kanë ndikim në jetën institucionale”, thotë sociologu Bekteshi. “Mbi bazën e kësaj, shumë shpesh gratë nuk e kanë zërin e njëjtë me burrat edhe nëse pozitën e kanë të njëjtë. Krejt këto vijnë si pasojë e stereotipave të krijuar e të cilat shpijnë në krijim të standardeve të dyfishta”.

Zotimi për vazhdimin e betejës për barazi

Ymeri, politikanja që tejkaloi pengesat lokale dhe mori besimin për deputete, thotë se rrethanat janë dukshëm më të favorshme për politikanët. “Gratë, si në zgjedhjet lokale ashtu edhe në ato parlamentare, shpesh detyrohen të udhëtojnë të shoqëruara nga një familjar i gjinisë tjetër. Edhe kur takohen me gra, prania e burrave në mjedisin e fushatës i kushtëzon ato që të kenë një shoqërues”.

Kuçi, që i sfidoi barrierat lokale e qendrore që shoqëria, përfshirë mediat, vetëdijshëm e pavetëdijshëm i ka vendosur për gratë, thotë se duhet të kuptohet që “ka një historik të gjatë të shtypjes e shfrytëzimit të grave botërisht, gati në çdo shoqëri, e kjo vazhdon ta minojë rolin e gruas në politikë. Duhet të synojmë që shoqërinë tonë ta shndërrojmë në një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë. Ndryshimet e mëdha nuk kanë ndodhur pa beteja të ashpura, të vazhdueshme dhe me vullnet politik”.

Autori është gazetar.

Hapësirat feministe të veprimit përballë sfidave globale, krizave ekonomike dhe populizmit



Karin Boven

“Barazia” është një nga themelet e kushtetutës holandeze, siç përcaktohet në Nenin 1: *Të gjithë personat në Holandë trajtohen në mënyrë të barabartë në rrethana të barabarta*. Megjithatë, në Holandë dhe në vende anembanë botës, përfshirë Kosovën, ende nevojiten veprime për të arritur barazinë dhe të drejtat universale, veçanërisht për gratë dhe vajzat.

Të drejtat, përfaqësimi, burimet dhe verifikimet e realitetit - këto janë katër parimet që e udhëheqin Politikën e Jashtme Feministe Holandeze (PJF, 2022), parime që mishërohen gjithashtu në gjithçka që unë bëj si Ambasadore.

Siç thuhet në parimin e të drejtave: “Gratë në mbarë botën duhet të jenë në gjendje t’i kërkojnë të drejtat e tyre universale dhe të dinë se ato janë të mbrojtura”. Ideja për të vepruar për hapësira feministe nënkupton të menduarit e të drejtave të barabarta dhe të barazisë si fokus kryesor në të gjitha aspektet kur një shtet harton një politikë feministe. Ndonjëherë kjo do të thotë të dalësh nga proceset e rehatshme të politikëbërjes dhe ndoshta të jesh pioniere në përpjekjen për të ngritur zërin për arsyet e duhura. Holanda synon të qëndrojë në këtë rrugë, unë qëndroj në këtë rrugë. Sepse, nëse më shumë njerëz kanë mundësi të barabarta, do të kemi vende më të sigurta e më stabile dhe një botë më gjithëpërfshirëse e më të begatë.

Duke qenë në Kosovë për gati dy vjet tashmë, kam qenë dëshmitare e drejtpërdrejtë se aktivizmi feminist është i lindur nga brenda, me përvoja të rrënjosura të grave që kanë kaluar një histori të tërë dhe mbajnë kaq shumë mbi supet e tyre. Aktivizmi i tyre formësohet duke u përballur me sfida të përditshme, por edhe duke jetuar për të dëshmuar sukseset e avokimit të tyre, gjë që është frymëzuese. Më kujtohet programi i praktikës për gratë rome, i mbështetur nga Holanda, i cili u siguroi grave të reja rome shkathtësi pune. Shumë prej tyre vazhduan të punonin në institucione të ndryshme dhe kështu u bënë pjesë-marrëse të mirëfillta në shoqëri.

Mënyra më e mirë për ta treguar parimin e përfaqësimit është që gratë të përfaqësohen dhe të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes politike. Si ambasadore, kam kuptuar se pavarësisht nëse flasim për vendin nga vijnë apo për vendin ku jemi të emëruara, hapësirat feministe duhet të mbeten arena jetike për kreativitet, angazhim politik dhe qëndrueshmëri, pasi ato kalojnë personalisht nëpër trendët globalë. Në Kosovë kam qenë dëshmitare e veprimeve pozitive përmes të cilave lëvizjet feministe i trajtojnë pabarazitë. Kam takuar shumë gra jashtëzakonisht të forta. Debatet që kam ndjekur trajtohen në mënyrë shumë profesionale, qoftë kur diskutohet puna joformale, Ligji i Punës, puna e papaguar e kujdesit, dhuna ndaj grave, kultura tradicionale apo përfaqësimi gjinor në media përmes FemTalks që organizon QKSGJ. Zgjedhjet dhe përfaqësimi i grave në partitë politike janë thelbësore për një demokraci funksionale. Ne

vazhdojmë të besojmë në këtë dhe aktualisht po e zbatojmë një projekt për fuqizimin e grave politikane në nivel lokal, sepse shumica e çështjeve trajtohen më së miri përmes një qasjeje nga poshtë-lart.

Duhet të sigurohemi që burimet e mjaftueshme të ndihmojnë në fuqizimin e hapësirave feministe. Hulumtimet ndërkombëtare tregojnë se kur bëhet fjalë për krizat ekonomike ato rrallëherë shpërnda-hen në mënyrë të barabartë. Komponenti gjinor shpesh përcakton se kush humb i pari dhe kush rimëkëmbet i fundit. Kush e bart barrën. Njëkohësisht, lëvizjet populiste i instrumentalizojnë ankthet kulturore, shpesh duke e paraqitur barazinë gjinore si një kërcënim të importuar ndaj vlerave tradicionale. Motivimi duhet të mbetet i fortë dhe burimet në dispozicion për të gjitha veprimet feministe duhet të shfrytëzohen për të siguruar pjesëmarrje kuptimplote të grave në infrastrukturën ekonomike të jetesës që mbështet demokracinë gjithëpërfshirëse.

Gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë botërore, megjithatë është e rrallë të gesh vende ku ato janë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë aty ku merren vendime për jetën e tyre, për shembull, në politikë dhe në bordet drejtuese. 1.2 miliardë gra jetojnë në vende ku nuk garantojnë të drejtat bazike. Përderisa të drejtat e grave dhe vajzave mbeten të pasigurta, ato do të përballen me diskriminim, përfshirë në aspektin financiar dhe ligjor,

qasje të pabarabartë në pronë, tokë, trashëgimi, kredi dhe arsim. Kështu shkelen të drejtat e grave dhe vajzave, duke i ekspozuar ato ndaj varfërisë, varësisë dhe dhunës.

Prandaj, duhet të mbetemi të qëndrueshëm në verifikimet e realitetit. Këto verifikime na japin arsye të mjaftueshme për t’u përqendruar në faktin se, kur rrethanat ndryshojnë nëpër botë dhe një qasje e caktuar nuk e ka të njëjtin efekt gjithkund, ne i zbatojmë synimet e politikave në një mënyrë që i përshtatet kontekstit lokal, pasi kjo shërben si një premtime themelor që përpjekjet të lulëzojnë.

Duke u mbështetur në kornizën tonë të PJF-së, kam organizuar dhe kam marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm ngjarjesh në Kosovë. Kam pasur një takim me një grup të përzgjedhur grash për Ligjin e Punës, kam organizuar një ngjarje për lidërsipin e grave dhe një ngjarje për gratë në tavolinën e dialogut në rezidencën time, kemi “bërë botën portokalli”, kam marrë pjesë në një panel për lidërsipin e grave të organizuar nga NDI, kam hapur rezidencën time për komunitetin queer dhe kam avokuar në çdo takim me partitë politike për rëndësinë e rolit të grave dhe balancës gjinore.

E gjithë kjo, dhe më shumë, është e nevojshme, sepse ende nuk kemi arritur aty ku duhet.

Autorja është Ambasadore e Mbretërisë së Holandës në Kosovë.



Luljeta Demolli

Ligji i aksionit dhe reaksionit në kontekstin e barazisë gjinore në Kosovë bëhet kristal i qartë çdoherë kur ka zgjedhje. Lokale, parlamentare dhe – mes vendimmarrësve, edhe presidenciale. Ndryshimet pozitive konceptuale dhe vlerore, realizuara në harmoni me angazhimet e vazhdueshme shumëdimensionale për avancime kualitative gjinore, tentohen të zvetënohen nga strategjitë manipulative që qëndisen mes zyrash dhe rrallëherë kuptohen në tërësi publikisht.

E vërteta zhgënjyese e stagnimit vërehet nga rezultatet e zgjedhjeve të fundit lokale dhe qendrore, si dhe në procesin e tashëm të zgjedhjes presidenciale.

Vetëm një kryetare komune, sall 5 nga 19 ministri, asnjë grua kandidat reale për presidente. Nëse s’do të ndodhte as zgjedhja e kryeparlamentares Haxhiu, gjendja do të bëhej katastrofale.

Ndikimi i grave në politikë, pavarësisht nga përpjekjet madhore gjatë viteve, tani është më i vogël se më parë. Edhe pse Ligji për Zgjedhjet kërkon përfaqësim të barabartë, listat e partive politike edhe kësaj here arritën vetëm pragun minimal prej 30 për qind. Kjo nuk është një statistikë e thjeshtë, por reflekton mungesën e vullnetit të partive për të promovuar barazinë gjinore dhe për të treguar që

Kosova vërtet e fuqizon progresin drejt barazisë gjinore.

Mungesa e investimeve cilësore programatike buron drejtpërdrejt nga mendësia e liderëve dhe grupeve të vogla rreth tyre, të cilat e promovojnë retorikën e zbrazët pa veprime konkrete.

Diskursi i përdorur ndaj grave gjatë dy fushatave, përfshirë edhe krizën aktuale, nuk është vetëm demagogji populiste. Ai funksionon si një kornizë për t’i formësuar perceptimet sociokulturore dhe për të riprodhuar stereotipa të vjetër: gratë nuk mund të jenë liderë në politikë. Ose: kur arrijnë në pozita të larta kjo ndodh vetëm përmes ndërmjetësimit të ndonjë lideri të fuqishëm – udhëheqës partie apo figurë patriarkale që qëndron në prapavijë.

Fillimi i marsit e ridefinoi problemin në gjithë gjerësinë e tij. Me afrimin e afatit kushtetues për zgjedhjen e presidentit/presidentes, formati i negociatave mes liderëve partiakë bëri që diskursi publik të rrëshqasë drejt idesë se pushteti është një hapësirë natyrisht ekskluzive maskuline.

Diskutimet u orientuan drejt burrave të familjeve me simbolika identitare historike. Jashari, Haradinaj, Hoti. Pohime dhe demante, përkrahje e kundërshtime. Mbi të gjitha, ajo që reflektohej thelbësisht në tërë këtë situatë ishte insistimi në rolin fundamental të trashëgimisë burrërore si parakusht kryesor të kapacitetit për udhëheqje të shtetit.

Ky mentalitet e thelloi maksimalisht idenë e ndarjes gjinore, pasi e përjashtoi mundësinë e përfshirjes së barabartë të grave në debatet për cilësitë personale dhe profesionale të kandidatëve. Ato u suspenduan shkaku i favorizimit apriori të vijës mashkullore të gjakut.

Shndërrimi i këtij qasjeje në normalitet të ri, veçanërisht pas pesë viteve presidenciale të Vjosa Osmanit, tregon synimin e ndërtimit të një konteksti të disfavorshëm për gratë në politikën e lartë.

Muaj më parë, përpjekje të ashpra gjinore për legjitimim elektoral u zhvilluan edhe përbrenda partive. Pa marrë parasysh dallimet ideologjike, në partitë e ndryshme taktikat vepruese ishin të njëjta. Gratë duhej të angazhoheshin pakrahasimisht më shumë se burrat për të fituar vota – ato u ballafaquan me kundërshtarë të partive tjera dhe të partive të veta, pasi funksiononin jashtë sistemeve korruptive që ishin ndërtuar nga struktura brendapërbrenda. Solidariteti gjinor u gjend para sulmeve të mëdha sistemore, gjë që i pengoi kauzat mobilizuese feministe në jetën politike.

Edhe në këtë 8 Mars po ndodh përhapja agresive e gjuhës mizogjene, veçanërisht përmes rrjeteve sociale, në të cilat ka shumë individë që janë duke e kapitalizuar financiarisht propagandën antigjinore. Rikthimi masiv i stereotipave dhe paragjytimeve gjinore krijon problematika të jashtëzakonshme dhe ndikon në frenimin e progresit të barazisë.

Sfida më e rëndësishme e grave në politikë është konsiderata për themelet mbi të cilat qëndrojnë fuqitë dhe pushtetet e tyre. Përfaqësimi nuk ka të bëjë vetëm me numra, por me autenticitetin dhe autoritetin meritator. Nuk guxojmë të lejojmë që sukseset e politikanëve të trajtohen të përkohshme, kurse të politikanëve të përherëshme.

Betejat tona përbëjnë esencën e demokracisë.

Autorja është Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore.



Kryeakademikja

Pas më shumë se gjysmë shekulli veprimtari, një grua zgjedhet në krye të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Akademike Justina Shiroka Pula, kryetare e ASHAK, ka ndërtuar një karrierë të gjatë akademike në Universitetin e Prishtinës, duke dhënë kontribut të rëndësishëm në fushën e ekonomisë, kërkimit shkencor dhe arsimit universitar. Përveç angazhimit akademik, ajo është dalluar edhe për përkushtimin e saj në fuqizimin e grave dhe promovimin e barazisë gjinore në shoqëri.



Cilat ishin sfidat më të mëdha që keni hasur në rrugëtimin drejt këtij posti?

Zgjedhja juaj si gruaja e parë që udhëheq Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës është një moment historik. Çfarë kuptimi personal ka për ju fakti që jeni gruaja e parë në krye të këtij institucioni?

Justina Shiroka Pula: Të jem gruaja e parë që udhëheq Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës është një nder i madh dhe një përgjegjësi e jashtëzakonshme për mua. Personaliteti dhe angazhimi im janë gjithmonë të lidhur ngushtë me përkushtimin ndaj shkencës dhe kulturës shqiptare, dhe kjo pozitë më jep mundësinë të kontribuoj në formimin e politikave dhe projekteve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e njohurive dhe të artit në vend. Përveç aspektit institucional, ky moment ka një kuptim shumë personal: është një dëshmi që grua mund të arrijë dhe të udhëheqë me sukses në hapësira historikisht të dominuara nga burra, duke treguar se me punë, përkushtim dhe mbështetje, çdo barrierë mund të tejkalohet.

Justina Shiroka Pula: Rruga drejt këtij posti ka qenë plot sfida, si profesionale ashtu edhe personale. Një nga sfidat më të mëdha ka qenë dëshmia e vazhdueshme se një grua mund të arrijë të udhëheqë në një institucion shkencor të nivelit të lartë, shpesh duke punuar më shumë se të tjerët për të fituar respektin dhe besimin e kolegëve. Përkushtimi dhe sakrificat ishin të mëdha, duke kombinuar angazhimin profesional me rolin në familje dhe edukimin e fëmijëve. Mbështetja e prindërve të mi dhe e bashkëshortit ka qenë vendimtare, sepse pa një rrjet mbështetës që të mundëson të përqendrosh në punë, arritja e qëllimeve të mëdha bëhet shumë më sfiduese.

Cilat janë prioritetet tuaja kryesore për zhvillimin e Akademisë në vitet e ardhshme?

Justina Shiroka Pula: Prioritetet e mia për Akademinë janë të qarta: forcimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit, rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar, modernizimi i strukturave dhe metodave të punës, si dhe mbështetja e grave në shkencë dhe art. Dua që Akademia të jetë një institucion modern, transparent dhe efikas, ku çdo anëtar ka mundësi të shprehë talentin dhe të kontribuojë në zhvillimin e vendit.

Çfarë hapash mendoni se duhen ndërmarrë për të rritur përfshirjen e grave në shkencë dhe në art?

Justina Shiroka Pula: Për ta rritur përfshirjen e grave në shkencë dhe art, është e domosdoshme të ofrohen mundësi të barabarta për arsimim, specializime dhe trajnime. Krijimi i rrjeteve profesionale, mentorimi, promovimi i grave të suksesshme dhe politika mbështetëse që lehtësojnë kombinimin e rolit profesional me përgjegjësitë familjare janë hapa kyç. Gruaja mund të arrijë të njëjtin sukses si burri, por shpesh i nevojitet më shumë përkushtim dhe sakrifica. Investimi në aftësitë dhe mbështetja e grave është çelësi për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm në shoqëri.

Çfarë mesazhi do të përcillnit për gratë dhe vajzat e Kosovës me rastin e 8 Marsit?

Justina Shiroka Pula: Me rastin e 8 Marsit, dua t'u them grave dhe vajzave të Kosovës se fuqia dhe potenciali juaj janë të jashtëzakonshme. Çdo arritje fillon me besim te vetja, përkushtim dhe guxim për t'i ndjekur ëndrrat tu-



aja, pavarësisht sfidave që mund të hasni. Mos u ndalni asnjëherë së lexuari, së mësuari dhe së punuari për t'u rritur profesionalisht dhe personalisht. Çdo hap që bëni përpara është një dëshmi se gruaja mund të arrijë të njëjtin sukses si burri, madje duke sjellë edhe pasion, përkujdesje dhe qasje unike në çdo fushë. Mbështetuni tek vetja, tek familja, dhe tek komuniteti,

dhe mos harroni se secila prej jush mund të bëhet model frymëzimi për brezat e rinj. Përvoja ime tregon se grua mund të arrijë të njëjtat rezultate si burri, por shpesh i duhet më shumë përkushtim dhe sakrifica.

8 Marsi është dita që na kujton forcën tonë, por edhe përgjegjësinë për të vazhduar të bëjmë ndryshime pozitive në shoqëri.

“Megjithatë, tani fjalën e kam unë” – Lufta e grave për t’u dëgjuar në Finlandë dhe Kosovë



Eevamari Laaksonen

Në vitin 1906, Finlanda u bë vendi i parë në Evropë që u dha grave të drejta të plota vote dhe të drejtën për t'u kandiduar në zgjedhje. Vetëm një vit më vonë, 19 gra u zgjedhën në parlamentin e sapokrijuar, Eduskunta. Ndërkohë, Kosova mbeti nën sundimin osman, ku as burrat dhe as gratë nuk gëzonin të drejta të mirëfillta politike.

Të dyja vendet tona kanë përparuar që atëherë. Sot gratë përbëjnë 46 për qind të deputetëve finlandezë. Në Republikën e Kosovës, përfaqësimi i grave në Kuvendin me 120 ulëse është rritur vazhdimisht gjatë dy dekadave të fundit - nga rreth 28 për qind në vitin 2001, në afërsisht një të tretën sot, gjithashtu pjesërisht falë kuotave progresive legislative.

Numrat ndryshojnë, dhe historitë janë të ndryshme, por realiteti mbetet i njëjtë: pjesëmarrja politike e grave nuk është dhënë kurrë falas. Si në Finlandë ashtu edhe në Kosovë, përparimi është arritur përmes këmbënguljes, guximit dhe vendosmërisë për të mos pritur leje. Dhe në të dy vendet, kjo përpjekje vazhdon ende.

Numrat ndryshojnë dhe historitë janë të ndryshme, por realiteti mbetet i njëjtë: pjesëmarrja politike e grave nuk është dhënë kurrë lirisht. Si në Finlandë ashtu edhe në Kosovë, përparimi është arritur përmes këmbënguljes, guximit dhe vendosmërisë për të hapur vetë rrugën. Dhe në të dy vendet, kjo përpjekje vazhdon ende. “Megjithatë, tani fjalën e kam unë,”

deklaroi deputetja finlandeze Miina Sillanpää (1866–1952), kur kolegët e saj burra kërkuar që ajo të heshte gjatë fjalimit të saj të parë në parlament në vitin 1907. Tema që ajo ngriti – fëmijët e lindur jashtë martese – konsiderohej e papërshtatshme, e pakëndshme dhe më mirë të injorohej. Por Miina këmbënguli. Nisma e saj fillimisht dështoi, por përfundimisht u miratua në vitin 1922. Ajo qëndroi në parlament për 38 vjet dhe u bë ministërja e parë grua në Finlandë, jo sepse sistemi e mirëpriti, por sepse ajo i mbijetoi rezistencës së tij.

Në vitin 2026, fjalët e Miinas mbeten jashtëzakonisht aktuale. Ato mishërojnë guximin dhe kërkojnë të dëgjoen. Ato flasin për padukshmërinë e grave në kohën e saj dhe, edhe pas 120 vjetësh, për sfidat me të cilat gratë përballen ende sot. Qëndrimi sfidues i Mininës jehon përtej Finlandës; ai qëndrim flet edhe për gratë në Kosovë. Në dy vendet tona, ende ka momente kur grave në politikë u thuhet, në mënyrë të tërthortë apo të hapur se kur duhet të flasin, çfarë duhet të mendojnë dhe sa ambicie është e pranueshme. Barazia e vërtetë arrihet vetëm kur gratë këmbëngulin ta marrin fjalën – gjithsesi, me guxim dhe pa ndrojtje.

Pjesëmarrja e plotë politike e grave nuk është vetëm çështje barazie: është kusht themelor i çdo demokracie. Epoka digjitale ka sjellë shumë përparësi për politikanët, si burra ashtu edhe gra, por gjithashtu edhe sfida të reja. Abuzimi dhe ngacmimi në internet janë bërë pengesa të fuqishme, veçanërisht për gratë, duke i dekurajuar ato të angazhohen në politikë, ose të flasin lirisht në publik.


Për gratë në politikë, hapësirat në internet rrallë janë neutrale. Rrjetet sociale mund të kthehen shpejt në platforma armiqësore, ku gjinia ka më shumë rëndësi sesa idetë politike. Sipas raportit “Gjuha e urrejtjes sensacionaliste online ndaj grave në politikë” të Institutit për Demokraci dhe

Zhvillim (D4D), dhuna në internet ndaj grave në Kosovë mbetet e vazhdueshme dhe po merr forma të reja. Ndërsa politikanët burra zakonisht kritikohen për idetë apo performancën e tyre, gratë në politikë shpesh përballen me sulme mizogjene, të seksualizuara dhe me ngarkesë morale, që e largojnë vëmendjen nga debatet politike dhe përdorin kundër tyre jetën private, pamjen apo marrëdhëniet e tyre. Me zhvillimin e inteligjencës artificiale dhe teknologjive të deepfake, këto sulme janë bërë më të sofistikuar, më të vështira për t'u kundërshtuar dhe më dëmtoese.

Ky fenomen nuk është i veçantë vetëm për Kosovën. Edhe në Finlandë, që shpesh përmendet si një vend model për barazinë gjinore, gratë në politikë përballen çdo ditë me abuzim, kërcënime dhe ngacmime në internet. Edhe pse Finlanda ka përqindjen më të lartë të grave në pozita të larta politike në Bashkimin Evropian, për shembull, 62 për qind e ministrave janë gra, mizogjinia në internet mbetet një realitet i zakonshëm. Kjo nxjerr në pah një të vërtetë të pakëndshme: barazia formale gjinore nuk garanton automatikisht pjesëmarrje të sigurt apo të barabartë në politikë. Dukshmëria në politikë, veçanërisht për gratë në pozita udhëheqëse, vazhdon të ketë një çmim.

Të vëzhguara bashkërisht, përvojat e abuzimit në internet në Kosovë dhe në Finlandë tregojnë një problem të përbashkët. Pavarësisht dallimeve në kulturën politike, burimet dhe nivelin e barazisë formale gjinore, abuzimi në internet ndjek modele të ngjashme përtej kufijve. Ai vë në shënjestër legjitimitetin e grave, dukshmërinë e tyre dhe të drejtën për të ushtruar pushtet. Kur abuzimi në internet normalizohet dhe shihet si “pjesë e punës”, ai në mënyrë të heshtur ndikon se kush qëndron dhe kush guxon të flasë.

Finlanda veçohet për faktin se ka ndërmarrë herët një qasje të integru-



ar ndaj abuzimit në internet, duke i përfshirë veprat përkatëse në kuadrin e përgjithshëm të ligjit penal, duke integruar luftën kundër ngacmimit në internet në punën e përditshme të policisë dhe duke e bërë edukimin digjital dhe sjelljen e përgjegjshme në internet pjesë të detyrueshme të kurikulës kombëtare të arsimit. Këto masa nuk e eliminojnë abuzimin, por tregojnë se si përgjigjet institucionale mund ta zhvendosin përgjegjësinë nga gratë individualisht drejt shtetit dhe autoriteteve publike. Përvojat e Finlandës mund të jenë të dobishme për Kosovën në ndërtimin e sistemit të saj mbi bazën e kornizave ekzistuese ligjore dhe institucionale.

Përvojat e grave në politikë në Kosovë dhe Finlandë na kujtojnë se përparimi nuk është as linear dhe as i garantuar. Sot, hapësirat feministe të veprimit shtrihen shumë përtej rrugëve dhe parlamenteve; ato ekzistojnë edhe në platformat digjitale, në ekosistemet mediatike dhe në diskursin e përditshëm politik. Mbrojtja e këtyre

hapësirave kërkon më shumë sesa qëndrueshmëri individuale nga gratë. Kërkohej përgjegjësi institucionale, rregullim i fortë i platformave në internet dhe refuzim kolektiv për ta pranuar ngacmimin si çmimin e pjesëmarrjes.

Kur gratë heshten, qoftë në një sallë parlamenti në vitin 1907, apo në një hapësirë në internet në vitin 2026, vetë demokracia dobësohet. Abuzimi në internet nuk i dëmton vetëm gratë individualisht. Ai e riformëson jetën politike duke duke përcaktuar se kush guxon të flasë, kush tërhiqet dhe kush nuk hyn kurrë fare në politikë. Këmbëngulja për të marrë fjalën mbetet mbetet një akt guximi politik. Të siguruarit që gratë mund ta bëjnë këtë në mënyrë të sigurt dhe lirisht është detyrim demokratik. Një detyrim për të cilin, si Finlanda ashtu edhe Kosova, duhet të vazhdojnë të punojnë pa u ndalur.

Autorja është Ambasadore e Finlandës në Kosovë.

Kriza, zgjedhja dhe argumenti për hapësirat feministe



Jürg Sprecher

Krizat zakonisht përkufizohen si periudha rreziku. Dhe po, ashtu janë. Por, ato janë gjithashtu edhe momente zgjedhjeje. Fjala greke krisis i referohet gjykimit: pikës në të cilën duhet të merret një vendim. Kjo e zhvendos fokusin nga tronditja te veprimi. Një krizë nuk na ndodh thjesht. Ajo është gjithashtu momenti në të cilin tregojmë çfarë jemi të gatshëm të mbrojmë dhe të krijojmë.

Sot shumë demokraci ndodhen në këtë pikë. Mjedise më të vrazhda sigurie, paqëndrueshmëria ekonomike, pasiguria energjetike dhe ndryshimet klimatike kanë nxjerrë në pah dobësitë që dikur konsideroheshin të menaxhueshme. Rrjetet sociale shpërblejnë shpejtësinë dhe zemërimin, ndërsa institucionet qëllimisht funksionojnë ngadalë. Qytetarët ndiejnë që supozimet e vjetra nuk vlen më, por ende nuk ka dalë në pah një alternativë e qëndrueshme.

Në kohë të tilla, të drejtat dhe institucionet nuk mund të merren si të mirëqena. Parimet që dukeshin të konsoliduara kërkojnë argumentim të ri, veçanërisht të drejtat e barabarta, demokracia dhe institucionet liberale që lidhin lirinë me prosperitetin. Ato duhet të mbrohen përmes bindjes, kompetencës institucionale dhe besimit publik. Ky është konteksti në të cilin hyjnë në lojë hapësirat feministe të veprimit.

Kriza dhe trysnia institucionale

Krizat ushtrojnë trysni mbi sistemet demokratike. Kur paqëndrueshmëria dhe pasiguria rriten, votuesit kërkojnë përgjigje dhe vendime të shpejta, ndërsa debati publik bëhet më i polarizuar.

Pavarësisht modeleve ideologjike, jo çdo vend rrëshqet në populizëm paternalist. Megjithatë, një rrezik i qartë është turrja e hapësirës qytetare të nevojshme për demokracinë. Qytetarët bëhen më pak të gatshëm të tolerojnë mospajtimin. Institucionet gjykohen vetëm për rezultatet e tyre afatshkurtra. Trupat e pavarur trajtohen si pengesa, kur në fakt duhet të shihen si mekanizma mbrojtës. Mbrojtja e pakicave paraqitet si opcionale.

Demokracia kërkon më shumë sesa thjesht zgjedhje. Ajo kërkon gjithashtu gjykata të pavarura, parlamente mbikëqyrëse, media të lira, administrata publike të paanshme dhe një kulturë qytetare në të cilën mospajtimi nuk e delegjtitmon tjetrin. Institucione të mbushura me jetë.

Edhe dimensionin ekonomik është po aq i rëndësishëm. Prosperiteti në shoqëritë moderne nuk buron nga kontrolli shtetëror, por nga miliona vendime të decentralizuara: punëtorë që lëvizin, sipërmarrës që marrin rrezeqe, huadhënës që alokojnë kapital, konsumatorë që zgjedhin dhe inovatorë që testojnë ide të reja. Ky proces kërkon rregulla dhe zbatim të parashikueshëm, si dhe besim se suksemi nuk do të varet kryesisht nga afërsia politike.

Kjo është arsyeja pse demokracia dhe kapitalizmi janë të ndërlidhura kaq ngushtë. Janë institucionet liberale ato që i lidhin këto fusha. Kur institucionet dobësohen, shoqëritë humbasin si lirinë, ashtu edhe dinamizmin ekonomik.

Të drejtat si masë e shëndetit institucional

Një tregues i rëndësishëm i cilësisë së institucioneve është statusi i grave dhe pakicave. Parimi i dinjitetit të barabartë para ligjit është themelor për një shoqëri të lirë. Të drejtat e grave dhe të pakicave seksuale e etnike nuk duhet të trajtohen si angazhime të paqëndrueshme në kohë të vështira.

Demokracitë marrin vendime më të mira kur përdoret e gjithë njohuria përkatëse. Kur pjesë të popullsisë nuk mund të flasin lirshëm, ose nuk kanë qasje në proceset vendimarrëse, cilësia e vendimeve përkeqësohet. Frika shtrembëron informimin. Një demokraci që nuk mund t'i dëgjojë qartë qytetarët e saj, përfundimisht do të qeverisë dobët.

E njëjta logjikë vlen edhe për jetën ekonomike. Një vend nuk mund ta ruajë zhvillimin duke e nënshfrytëzuar një pjesë të konsiderueshme të potencialit të tij njerëzor. Pjesëmarrja e grave nuk është vetëm çështje drejtësie, megjithëse padyshim që është edhe kjo. Ajo është gjithashtu çështje produktiviteti, konkurrueshmërie dhe qëndrueshmërie, sepse ekziston një lidhje e fortë midis prosperitetit dhe barazisë gjinore.

Hapësirat feministe si infrastrukturë demokratike

Kjo na çon te thelbi: hapësirat feministe. Argumenti më i fuqishëm për to nuk është ideologjik. Është institucional. Që qytetaria e barabartë të jetë më shumë sesa një koncept abstrakt, qytetarët kanë nevojë për hapësira ku mund të bëhen akterë efektivë. Të drejtat formale nuk e eliminonin qasjen e pabarabartë në rrjete, mentorim, dukshmëri publike, përvojë politike, apo njohuri organi-

zative. Hapësirat feministe mund të ndihmojnë në zvogëlimin e këtyre pabarazive.

Në formën e tyre më të mirë, këto hapësira zhvillojnë leadership dhe vetëbesim. Ato i lidhin individët me institucionet, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe krijojnë kanale përmes të cilave gratë mund të kalojnë nga shqetësimi në veprim dhe nga veprimi në përgjegjësi.

Pse trajektorja e Kosovës ka rëndësi më të gjerë?

Këto pyetje nuk janë abstrakte në Kosovë. Kosova është një shtet sovran me aftësi veprimi dhe zgjedhje politike. Por, trajektorja e saj ka gjithashtu rëndësi më të gjerë.

Shtetësia e saj është e lidhur ngushtë me idenë e një rendi botëror të bazuar në rregulla, në të cilin konfliktet e dhunshme mund të tejkalohen përmes institucioneve demokratike, mbrojtjes së të drejtave të njeriut (përfshirë të drejtat e pakicave) dhe zhvillimit ekonomik: një koncept që sot është nën trysni në shumë vende. Prandaj, përparimi i Kosovës ka rëndësi përtej kufijve të saj.

Sepse Kosova përmban njëkohësisht përgjegjësi dhe mundësi. Zgjedhjet e saj kanë rëndësi strategjike pikërisht pasi ajo është aktere: një aktere në përmirësimin e rezultateve të brendshme, por edhe në kredibilitetin e saj gjeopolitik. Për rrjedhojë, pjesëmarrja e grave dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave duhet të njihen si pjesë përbërëse e fuqisë shtetërore të Kosovës.

Nga partneriteti te veprimi politik

Këtu hyn në funksion rëndësia e partneriteteve afatgjata. Angazhimi i Zvicrës në Kosovë për gati tri dekada pasqyron një kuptim të qën-

drueshmërisë: prosperiteti dhe përparimi demokratik ndërtohen përmes punës së vazhdueshme me institucionet, akterët lokalë dhe kapacitetin publik.

Mbështetja e Zvicrës për hapësirat feministe është pjesë e një strategjie më të gjerë të përfshirjes demokratike dhe ekonomike. Programi i Bashkëpunimit Zviceran në Kosovë e integron barazinë gjinore në qeverisje, paqe, zhvillim ekonomik, klimë dhe shëndetësi. Kjo nënkupton se cilësia institucionale varet nga kush ka mundësi të marrë pjesë dhe të udhëheqë, dhe interesat e kujt pasqyrohen në politika.

Angazhimi ynë në pjesëmarrjen politike të grave dhe puna jonë e ardhshme për fuqizimin ekonomik të grave janë investime në aftësinë për veprim. Ato zgjerojnë rrethin e qytetarëve që mund të organizohen, të flasin dhe të kontribuojnë në prosperitetin e përbashkët.

Megjithatë, argumenti më i gjerë shkon përtej çdo partneri të vetëm të jashtëm. Një krizë teston nëse një shoqëri mund t'i përkthejë parimet në praktikë: të drejtat në institucione, lirinë në përgjegjësi dhe mospajtimin publik në vendime funksionale. Partnerët ndërkombëtarë mund ta mbështesin këtë proces, por janë qytetarët ata që duhet ta realizojnë.

Kjo është rëndësia më e thellë e krisis. Në periudha trazirash, pyetja nuk është vetëm çfarë ka frikë një shoqëri se do të humbasë, por çfarë zgjedh të ruajë dhe çfarë zgjedh të ndërtojë më pas. Hapësirat feministe të veprimit janë veçanërisht të rëndësishme në këto momente, sepse ato rrisin kapacitetin e një shoqërie për të qeverisur veten në mënyrë efektive në kohë sfiduese dhe për ta ndërtuar një të ardhme më të mirë.

Autori është Ambasador i Zvicrës në Kosovë.

20 vjet Agjenci për Barazi Gjinore: Sfida, përkushtim dhe të arritura



Edi Gusia

Në vitin që shkoi, Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës shënoi 20 vjetorin e themelimit të saj, duke punuar çdo ditë për të siguruar legjitimitetin kushtetues dhe të drejtat e patjetërsueshme të konventave ndërkombëtare për të drejtat e grave dhe barazisë gjinore, realizimin e aspiratave dhe sakrificave të qytetarëve dhe qytetarëve të Kosovës për të drejta, dinjitet dhe barazi. Në 20 vjetorin e ABGJ-së shënuam bashkërisht edhe 30 vjetorin e Platformës për Veprim të Pekinit, 25 vjetorin e Rezolutës 1325 “Gratë, Paqja dhe Siguria”, 20 vjetorin e kornizës së parë ligjore për barazi gjinore në Republikën e Kosovës, si dhe 10 vjetorin e Ligjit për Barazi Gjinore.

Këto data historike u shënuan në kontekst global sfidues - në kohë luftërash globale, në një vit kur bota po përballej dhe vazhdon të përballët me një kthim mbrapa në zbatimin e agjendës për barazi gjinore dhe të drejtave të grave, ku me përshkallëzimin e konflikteve hapësira për veprim po tkurret.

30 vjet pas Pekinit, bota është 120 vite mbrapa arritjes së barazisë mes burrave dhe grave, ndërsa barazia gjinore kurrë nuk ka qenë më e kër-

cënuar, duke e vënë në pikëpyetje ekzistencën e vlerave të krijuara dhe fituara me sakrifica dhe me përpjekje madhore!

Shënimi i përvjetorëve të spikatur është arsye sa për festim, po aq për veprim. Platforma e Pekinit 1995 u krijua si nevojë për veprim për zbatimin e jetësimin e CEDAW. Vetë CEDAW lindi si domosdoshmëri ekzistenciale. ABGJ-ja u krijua dhe ekziston si domosdoshmëri për veprim, si frymë, si përkushtim ndaj të drejtave por edhe detyrimeve që kemi ndërmarrë; ekziston si domosdoshmëri e kurajës për t'u përballur me sfidat, barrierat e betejat për të drejtat e barabarta të grave dhe vajzave për qasje të barabartë në burime financiare, jetë publike dhe politike. Rrugëtimi ynë në zbatimin e mandatit nuk ishte i njëtrajtshëm, përkundrazi navigoi në shumë situata të kthimit mbrapa, dhe ato u tejkaluan vetëm falë vullnetit dhe angazhimit të shumë grave dhe burrave të përkushtuar që ishin dhe janë pjesë e institucionit.

Ndër të arriturat më të rëndësishme të ABGJ-së në këto vite 20 janë: hartimi i tërë kornizës ligjore për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave, i plotësuar në vitin 2022, si dhe instrumenteve zbatuese të tij; propozimi i masës afirmative “Udhëzimi administrativ për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve pa pagesë”, i filluar me 105 çifte në 2016, ndërsa në dhjetor 2025 kishim 31.124 çifte; disbursimi i dy milionë eurove për organizatat e grave dhe bizneset e grave/çerdhjet si mbështetje gjatë Covid-19; mbështetja e rreth 200 organizatave joqeveritare

të grave; komentimi me synim të integritetit gjinor i 207 draft-akteve ligjore dhe nënligjore dhe 134 draft-politikave publike dhe planeve të veprimit; realizimi i dhjetëra fushatave sensibilizuese dhe prodhimi i 46 videospoteve televizive për sensibilizim, emancipim dhe vetëdijësim të opinionit për të drejtat e garantuara për barazi gjinore.

Ndër arritjet më të mëdha të ABGJ-së është bashkëpunimi i ngushtë me Fakultetin Ekonomik për të futur perspektivën gjinore në mësimdhënie dhe kërkim shkencor; vendosja e lëndës “Gjinia dhe Ekonomia”, në mënyrë që studentët e ekonomisë të analizojnë tregun, punësimin dhe politikat publike përmes vlerësimit të ndikimit gjinor; të mësojnë si të krijojnë politika më të përgjegjshme, më të drejta dhe më efektive, dhe mbi të gjitha, të planifikojnë dhe ndërtojnë një ekonomi më gjithëpërfshirëse.

Prandaj, ky 20 vjetor i ABGJ-së është mesazh falënderues për demokracinë e re, ndër më të rejtat në botë, atë të Republikës së Kosovës, që arriti të themelojë, mbështesë, dhe mbajë në fokus një mekanizëm të tillë politik hartues, monitorues dhe zbatues në nivelin më të lartë të vendimarrjes – në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Është për t'u vlerësuar ruajtja e neutralitetit politik institucional, financimi i qëndrueshëm në pesë vitet e fundit, vija e drejtpërdrejtë e raportimit me udhëheqësin e ekzekutivit dhe komunikimi i përhershëm me shërbimin civil për zbatimin e agjendës për barazi gjinore, në harmoni me rekomandimet e Platformës së Pekinit, obligimeve të CEDAW dhe rekomandimeve të Rezolutës 1325.



20 vjet ABGJ do të thotë dedikim dhe përkushtim për institucione të qëndrueshme, transparente, dhe të përkushtuara për të ofruar mbështetje dhe shërbime për gra dhe burra të Kosovës pa dallim gjinie, moshe, etnie, apo orientimi seksual. Kjo nuk do të ishte e mundur pa angazhimin e të gjithë akterëve: Kuvendit, Qeverisë, Presidencës, shërbimit civil dhe bashkëpunëtorëve tanë - zyrtarëve/eve për barazi gjinore dhe posaçërisht organizatave të grave, bashkëpunimi me të cilat ka qenë kyç. Po ashtu, një rol shumë të rëndësishëm kanë luajtur edhe partnerët tanë bilateralë dhe multilateralë, mbështetja e të cilëve ka pasur dhe vazhdon të ketë domethënie jetike për avancimin e barazisë gjinore në vend.

Janë dashur 20 vjet investime e politikëbërje, por mbi të gjitha është

dashur mbi dy dekada krijim i vetëbesimit, përkushtim, përpjekje, kurajë dhe dashuri për punë dhe vend. Nuk mund të presim 120 vite për barazi, mund ta bëjmë edhe në 20 vite, apo 12 vite. Ajo që është në kapacitetet tona është që të përpigemi çdo ditë, pa hezitim, për përjetimin e misionit tonë për ne sot, e për bijtë e bijat tona, motrat tona, drejt së ardhmes.

Ky 20 vjetor është rast që t'i kujtojmë aktivistët që nuk janë më mes nesh, por na shtruan rrugën me sakrificat e tyre, me përpjekjet e tyre dhe shënim të përkushtimit tonë të rinovuar ndaj Platformës për Veprim të Pekinit për barazi gjinore, veprim dhe drejtësi!

Autorja është Kryeshefe Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore.

Udhëheqja e tipit “i forti ka të drejtë” e ka prishur rendin botëror. A mund ta riparojë feminizmi atë?



Caterina Bolognese

Rendi ligjor ndërkombëtar nuk ishte kurrë i përsosur. Ai mbështetej në një parakusht të brishtë: që shtetet do t'i nënshtroheshin rregullave të përbashkëta, standardeve minimale dhe respektit të ndërsjellë. Ajo “marrëveshje zotërinjsh” shumëpalëshe tani është e dëmtuar dukshëm; shumëkush do të thoshte e thyer në mënyrë të pariparueshme.

Por, le të jemi të sinqertë për problemin më të thellë. Rendi global, siç e kemi njohur, ka qenë në thelb patriarkal: një *marrëveshje zotërinjsh të supozuar*. Të drejtat e grave përparuan brenda tij, po – por shpesh si lëshime të dhëna me ngurrim nga personalitete me ndikim në pushtet. Vetë sistemi mbeti i magjepsur nga miti i udhëheqësit të pagabueshëm: vendimtar, dominues dhe në fund të fundit - i papërgjegjshëm.

Sot, ky mit është shembur nën peshën e vetë teprimeve të tij.

Po jetojmë një periudhë përcarjeje. Nga normalizimi i udhëheqësve populistë deri te ekspozimi i rrjeteve elitare të pandëshkueshmërisë, besimi publik në institucione është në nivelin më të ulët ndonjëherë. Këto kriza nuk janë skandale të izoluar; ato zbulojnë dështime sistemike të llogaridhënies dhe kultura të të drejtave të mbrojtura prej kohësh nga hetimi.

Në qendër qëndron një model i njohur: abuzimi i pushtetit nga burrat e socializuar në dominim dhe të shpërblyer për arrogancë. Sistemet patriarkale ngrenë arrogancën mbi përlulësinë, spektaklin mbi përmbytjen, mizorinë mbi bashkëpunimin. Ata e ngatërrojnë pakujdesinë me guximin. Me kalimin e kohës, vetë shteti bëhet një zgjatim i një egoje të dëmtuar.

Kjo nuk do të thotë që narcizmi është një tipar tipik mashkullor. Gratë janë plotësisht të afta të abuzojnë me pushtetin dhe të lejojnë egon t'i drejtojnë zgjedhjet e tyre të udhëheqësisë. Por, patriarkati i vendos burrat në mënyrë disproporcionale në pozicione ku teprimet e tyre mund të përdoren si armë - përmes ushtrive, buxheteve, medias dhe ligjit.

Autokracitë e bëjnë të dukshme këtë dinamikë. Megjithatë, demokracitë nuk janë imune. Zgjedhjet, si të vetme, nuk mbrojnë kundër qeverisjes së drejtuar nga egoja. Kur gjykatat janë të politizuara, mediat e kapura dhe shoqëria civile e dobësuar, fasadat demokratike mund të bashkëjetojnë me praktikën autoritare. Në mjedise të tilla, të drejtat e grave janë një shënjestër e lehtë. Kontrolli, veçanërisht mbi trupat e grave, bëhet mjet për të konsoliduar pushtetin.

E çka tash? Në kohëra të trazuara, tundimi është të tërhiqemi – t'i ulim ambiciet dhe t'i zvogëlojmë angazhimet feministe nga presioni i reagimit të ashpër kundër “vetëdijesimit”. Ky instinkt është i kuptueshëm, por nuk do të na çojë askund. Ky moment kërkon një rishqyrtim më të thellë, një që mund të ndikojë në transformim në një rend botëror krejtësisht të ri dhe më të mirë.

Rendi ligjor ndërkombëtar ka nevojë për një rifillim feminist.

Multilateralizmi, i kuptuar siç duhet, tashmë e hedh poshtë pagabueshmërinë. Ai shpërndan pushtetin dhe e ngulitë vendimarrjen në konsultim dhe llogaridhënie të ndërsjellë. Ai këmbëngul që sovraniteti nuk jep përjashtim moral. Multilateralizmi *feminist* shkon më tej: ai e vendos barazinë gjinore, autonominë trupore dhe lirinë nga dhuna në themel të qeverisjes legjitime - jo në kufijtë e saj.

Kjo nuk ka të bëjë me futjen e më shumë grave në hierarkitë ekzistuese dhe shpalljen e fitores. “Integrimi gjinor” teknokratik mund ta zvogëlojë barazinë në një ushtrim me shënime kutish. Një rifillim feminist, nga ana tjetër, duhet *t'i riformësojë normat e vetë pushtetit*.

Së pari, një rend i ri dhe më i mirë ligjor ndërkombëtar duhet të hedhë

poshtë standardet e dyfishta dhe të përballet me pandëshkueshmërinë. Rrjetet e abuzimit dhe korrupsionit lulëzojnë në heshtje dhe bashkëfajësi. Një qasje feministe kërkon mekanizma transnacionalë të llogaridhënies që mbrojnë sinjalizuesit, u kushtojnë vëmendje viktimave, fuqizojnë të mbijetuari/at dhe e trajtojnë dhunën me bazë gjinore si një çështje strukturore - jo një shqetësim për reputacionin.

Së dyti, ai duhet t'i sfidojë kushtet ekonomike që nxisin autoritarizmin.

Masat shtrënguese, krizat e borxhit dhe tronditjet globale krijojnë pakënaqësi të gatshme për shfrytëzim.

Gratë - veçanërisht ato në role kujdesi të pasigurta ose të papaguara – i vuanë pasojat në mënyrë disproporcionale. Një kornizë feministe e trajton mbrojtjen sociale, shërbimet publike dhe infrastrukturën e kujdesit si themele të rezistencës demokratike, jo si kosto të shpenzueshme.

Së treti, që ndoshta është më e rëndësishmja, një rend i ri ligjor ndërkombëtar duhet ta ripërcaktojë udhëheqjen dhe ta ngulisë këtë përkufizim në strukturat e pushtetit. Udhëheqja feministe nuk është çështje e zëvendësimit të personalitetit; është ndryshim normativ. Ajo çmon inteligjencën kolektive mbi guximin individual. Ajo mirëpret mospajtimin në vend se ta ndëshkojë atë. Ajo e kupton cenueshmërinë si njerëzore, jo si diskualifikuese. Askush - grua apo burrë - nuk është përtej hetimit. Një rifillim i udhëheqjes transformuese gjinore do të thotë pushtet i kufizuar, standarde transparente, llogaridhënie e përbashkët.

Patriarkati thotë se dominimi është i barabartë me vlerën, se dukshmëria është e barabartë me vlerën, se kontrolli është i barabartë me kompetencën. Feminizmi i prish këto mite. Ai ekspozon se si varësia ndaj pushtetit gërryen si institucionet, ashtu edhe individët. Ai këmbëngul se drejtësia nuk është një garë me shumë zero dhe se dinjteti nuk është i negociueshëm.

Në kohë krize, mbështetja e një udhëheqësi “të fortë” mund të ndihet stabilizuese. Krenaria kombëtare mund të përdoret si armë kundër kritikës, të hidhet poshtë si jobsenike, ose “tepër e vetëdijësuar”. Feminiz-



mi i reziston këtij përkufizimi. Patriotizmi dhe besimi në institucione janë të pajtueshëm me hetimin - në fakt, varen prej tij. Sovraniteti forcohet, nuk dobësohet, nga llogaridhënia.

Thyerja në rendin global është shkatërruese, por po e sqaron edhe veten. Sistemet e ndërtuara rreth egos dhe pandëshkueshmërisë janë ekspozuar si të brishta. Perandori patriarkal është i zhveshur.

Pyetja nuk është më nëse udhëheqja e tipit “i forti ka të drejtë” po dështon. Por, nëse jemi të përgatitur të ndërtojmë diçka më të fortë në vend të saj.

Multilateralizmi feminist ofron më shumë sesa kritikë. Ai ofron ndërtim: qeverisje të përbashkët, llogaridhënie strukturore dhe këmbëngulje radikale se dinjteti i grave dhe vajzave - në fakt, i të gjithë njerëzve - është masa e pushtetit legjitim.

Rendi botëror mund të jetë prishur nga një politikë dominimi. Nuk do të riparohet nga e njëjta gjë.

Autorja është Shefe e Barazisë Gjinore në Këshillin e Evropës.

Këto janë pikëpamjet e saj personale.

Zinxhiri që i mban gratë jashtë tregut të punës

Donika Gashi

Kur po kërkoja çerdhe për djalin tim, pas muajsh që kisha kaluar me të në shtëpi, fillova të interesohesha për çerdhe publike. Një shoqe më tha me shaka: “Më lehtë e ke me e regjistru në Fakultetin e Mjekësisë, sesa në çerdhe publike!”. Ishte ironi, por jo larg realitetit. Për shumë prindër, veçanërisht për gratë, mungesa e çerdheve publike reflekton një problem të gjerë struktural dhe social që ndikon në pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës dhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në gjithë Kosovën funksionojnë vetëm 65 çerdhe publike dhe 177 private. Në Prishtinë ka vetëm 8 çerdhe publike dhe mbi 80 private. Çmimi për një vend në një çerdhe publike është rreth 50 euro në muaj, ndërsa tarifat e çerdheve private janë mesatarisht 200 euro, pagesë e lartë kur merret për bazë paga mesatare bruto prej 639 euro në muaj. Për shumë gra kjo do të thotë që duhet të zgjedhin mes punës së paguar dhe kujdesit për fëmijët. Si rezultat, vetëm 8.9 për qind e fëmijëve nën moshën pesë vjeç janë të regjistruar në arsimin parashkollor, ndërsa pjesa tjetër marrin kujdes kryesisht nga një grua në shtëpi.

Kjo mungesë infrastrukture ka pasojat e drejtpërdrejta për pjesëmarrjen

e grave në tregun e punës. Vetëm një në katër gra (25.9 për qind) është pjesë e fuqisë punëtore, edhe pse gjysma e grave janë në moshë pune. Shkalla e papunësisë së grave qëndron rreth 19 për qind, trefish më e lartë se mesatarja e Bashkimit Europian, ndërsa shkalla e punësimit është vetëm 21.2 për qind, më e ulët në rajon. Gratë shpenzojnë mesatarisht 6.2 orë në ditë për punë të paguar për kujdesit, ndërsa burrat vetëm 3.5 orë. Kjo tregon jo vetëm pabarazi në ndarjen e përgjegjësisë familjare, por edhe një pengesë të qartë që u kufizon grave mundësinë për të kërkuar dhe mbajtur një punë të paguar.

Një hulumtim i Rrjetit të Grave të Kosovës tregon se 91 për qind e grave do të dëshironin të punonin nëse do të mund ta përballonin dërgimin e fëmijëve të tyre në çerdhe. Këto të dhëna e bëjnë të qartë se qasja në kujdesin për fëmijët nuk është çështje zgjedhjeje individuale, por pasojë e drejtpërdrejtë e politikave publike dhe prioriteteve shtetërore.

Por, edhe kur të dy prindërit punojnë me orar të plotë, gratë shpenzojnë 33 për qind më shumë kohë në punë të paguar krahasuar me burrat. Kjo tregon se përveç barrierave financiare, barrierat kulturore dhe ligjore po ashtu i ndalojnë gratë të kthehen në

tregun e punës pas lindjes. Një politikë e barabartë prindërore, me pushim të njëjtë për të dy prindërit, shërbime më të përballeshme dhe më të shumta për kujdesin e fëmijëve, si dhe mundësi për punë fleksibile, mund të reduktojë ndjeshëm penallitetin e amësisë dhe të rrisë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.

Një analizë krahasuese e politikave të pushimit prindëror në 21 vende tregon se sistemet ku lejet për kujdesin ndaj fëmijëve janë më të barabarta midis nënave dhe baballarëve ndikojnë në reduktim të hendekut gjinor në punësim. Studimi identifikon se kur politika zbatohet në mënyrë që baballarët marrin leje prindërore kjo praktikë lidhet me rikthimin e grave në punë dhe i redukton pabarazitë në tregun e punës.

Roli kryesor i grave si kujdestare për fëmijët është i përforcuar edhe nga ligjet aktuale për pushimin e lehonisë. Ligji i Punës i jep nënës deri në 12 muaj pushim dhe babait vetëm dy ditë, plus deri në dhjetë ditë pa pagesë. Kjo situatë krijon një penallitet të dukshëm për gratë, të njohur ndërkombëtarisht si “penaliteti i amësisë”. Punëdhënësit shpesh i konsiderojnë nënat më pak të dëshirueshme për punësim dhe shumë gra përballen me kontrata

afatshkurtra, punë me orar të pjesshëm, ose mungesë të kontratës. Edhe kur gratë kthehen në punë pas pushimit të lehonisë, shumë prej tyre përballen me paga më të ulëta, reduktim të përgjegjësisë, ose orar të shkurtuar pune.

Megjithatë, kjo kornizë ligjore nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimet dhe gatishmërinë e vetë qytetarëve. Ndërsa ligji e përforcon modelin tradicional ku kujdesi për fëmijën mbetet pothuajse ekskluzivisht përgjegjësi e nënës, pyetja që lind është nëse shoqëria vazhdon ta mbështesë këtë ndarje të pabarabartë, apo është e gatshme për një model më të barabartë.

Sipas hulumtimit “Ndryshimi i paradigmes – Barazi përmes lejes prindërore”, të realizuar në 2017 nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), ekziston një mbështetje e konsiderueshme shoqërore për reformimin e modelit aktual të lejes prindërore në Kosovë. Gjetjet tregojnë se 77.8 për qind e burrave dhe grave do ta konsideronin marrjen e lejes prindërore, ndërsa 41.9 për qind e të gjithë mostrës do ta konsideronin ndarjen e lejes me partnerin/en e tyre (41.8 për qind e burrave dhe 45.8 për qind e grave). Veçanërisht, brezat e rinj (18–24

vjeç) dhe grupmosha 35–44 vjeç kanë shprehur shkallë më të lartë gatishmërie për të marrë leje prindërore, përkatësisht 46.6 për qind dhe 47.8 për qind. Këto të dhëna sugjerojnë se ekziston një bazë e qartë sociale për një model më të barabartë të lejes prindërore, i cili do t'i shpërndante më drejt përgjegjësitë e kujdesit dhe potencialisht do të ndikonte në rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës.

Prandaj, diskutimi për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës nuk mund të reduktohet në “vullnet personal”, apo “motivim”, por lidhet drejtpërdrejt me mënyrën se si organizohet kujdesi në një shoqëri. Kur kujdesi ndaj fëmijëve mbetet përgjegjësi kryesisht e grave, ekonomia humb një pjesë të konsiderueshme të potencialit të saj.

Historia ime me kërkimin e një çerdheje pasqyron realitetin e mijëra grave që çdo ditë negociojnë mes përgjegjësisë familjare dhe aspiratave profesionale, shpesh pa mbështetje të mjaftueshme institucionale. Zgjedhja mes amësisë dhe karrierës nuk duhet të jetë një dilemë personale, por një çështje që adresohet me politika publike të menduara mirë.

Autorja është gazetare.

Barazia gjinore nuk është luks, nënfinancimi bie regres



Vlora Tuzi Nushi

Në një ditë të rëndomtë në fund të vitit të kaluar, mora një thirrje nga Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës. Fillimisht kur u prezantuan, mendova që ishte ftesë për të marrë pjesë në ndonjë ngjarje. Nuk doli të ishte ashtu. Telefonata ishte thirrje për ndihmë. Aktiviteti i tyre ishte pothuajse në shuarje dhe gjithçka që donin ishte të paktën ta mbanin të hapur zyrën. Fondet mungonin edhe për qira. Ky Komitet ekziston që nga viti 2003 dhe ka ndihmuar plot gra e vajza të verbra përmes aktiviteteve arsimore, edukative, vetëdijesuese dhe informuese.

Thirrje të ngjashme mora edhe nga organizata të tjera. Por, edhe fondet tona si UN Women, Agjenci e Kombeve të Bashkuara, ishin të limituara.

Këto telefonata jepnin një indikacion: aktivistet ishin në rrezik.

Sapo kaluam në 2026-ën, një thirrje tjetër për një takim me shqetësim erdhi nga organizatat lidere që me dekada kanë punuar për të drejtat e grave dhe fuqizimin e tyre, që kanë ndikuar në ngritje të vetëdijes e deri te ndryshimet e mëdha në legjislacion, të cilat i gëzojmë sot.

“Po përballemi me vështirësi financiare!” – ishte maksima e takimit të fundit të Grupit për Siguri dhe Barazi Gjinore, një grup shumëanëtarësh, i udhëhequr nga UN Women dhe Agjencia për Barazi Gjinore.

Takimi i mbajtur në fillim të shkurtit krijonte shqetësime dhe shfaqte pasiguri. Organizatat që punojnë për të drejtat e grave, në avancim të legjislacionit, politikëbërje e avokim, kishin shkurtime të dukshme fondesh.

Ndonëse theksohej që legjislacioni nuk ka degraduar dhe korniza ligjore për barazi gjinore qëndron fuqishëm, financimi për të shtyrë përpara drejt progresit po reduktohet.

Hapësira për veprim feminist për-fundimisht është vënë nën presion edhe në Kosovë dhe jo për shkak të uljes së nevojës për barazi, por për shkak të uljes së mbështetjes financiare. Regresi global i dokumentuar në raportin e UN Women “Në rrezik dhe të nënfinancuara”, i cili tregon se një e treta e organizatave që punojnë për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave kanë qenë të detyruara të pezullojnë, mbyllin apo zvogëlojnë shërbimet për shkak të shkurtimeve të fondeve, ka prekur shpejt edhe kontekstin tonë lokal. Sipas këtij raporti, rreth 90 për qind e organizatave raportuan reduktime të konsiderueshme të qasjes ndaj shërbimeve kyçe, si strehim, mbështetje ligjore dhe psikologjike, ndërsa shumë prej tyre rrezikojnë shuarjen brenda pak muajsh nëse financimi nuk rigjenerohet.

Ky trend global, ku fondet pakësohen ndërsa nevojat janë në rritje, ndikoi me ulje të mbështetjes edhe për organizatat në Kosovë që e adresojnë dhunën ndaj grave, si dhe përkrahjen e brezave të grave aktiviste dhe profesioniste që i mbajnë gjallë sistemet e mbështetjes. Në dekadat e fundit është punuar shumë për të sjellë ndryshime që kanë përmirësuar jetën e grave dhe vajzave në vend, por në këtë shkrim nuk dua t’i përmend sukseset, ndonëse ato rrezikohen. Dua të shqyrtoj se çfarë ndodh kur mbështetja zbehet dhe çfarë humbim kur fondet që mbajnë gjallë hapësirën feministe tkurren.

Në të njëjtën kohë, diskursi publik po bëhet gjithnjë e më i ashpër ndaj barazisë gjinore. Narrativat që e relativizojnë dhunën, që e paraqesin barazinë gjinore si “agjendë dytësore”, ose si çështje që “nuk është prioritet”, po fitojnë hapësirë. Në këtë klimë, mungesa e financimit jo vetëm që tolerohet, por edhe justifikohet.

Kjo është veçanërisht shqetësuese për Kosovën, ku barazia gjinore është

e garantuar me Kushtetutë dhe ku ekziston një kornizë ligjore relativisht e avancuar. Ligjet, megjithatë, nuk zbatohen vetë. Ato kërkojnë burime, institucione funksionale dhe bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile. Pa investim real, kornizat ligjore mbesin deklarative.

Për më tepër, barazia gjinore në Kosovë nuk është interes i një grupi të vogël aktivistesh. Është interes publik. Ajo përfaqëson një mekanizëm paralajmërues, mbrojtës dhe korrigjues për një shoqëri që ende po përballet me pabarazi strukturore gjinore. Dobësimi i kësaj hapësire do të thotë më pak llogaridhënie, më pak mbrojtje, më shumë heshtje.

Raporti i UN Women thekson se pa financim të qëndrueshëm për organizatat e grave, përpjekjet për të ndalur dhunën ndaj grave dhe vajzave rrezikojnë të dështojnë (UN Women: “At risk and underfunded”, 2025). Për Kosovën kjo do të thotë rrezik real për thellimin e pabarazive ekzistuese dhe për normalizimin e dhunës e diskriminimit si problem privat, e jo si përgjegjësi institucionale.

Ky realitet nuk është as i izoluar dhe as i rastësishëm. UN Women e përshkruan qartë këtë moment si një pikë kthese për barazinë gjinore: një kontekst ku përparimi po përballet njëkohësisht me kriza ekonomike, presione politike, rritje të populizmit dhe reagime të ashpër ndaj të drejtave të grave. Në analizat e vazhdueshme, sidomos në vitin 2025, theksohet se zvogëlimi i fondeve për barazi gjinore dhe organizatat e grave nuk është vetëm problem financiar, por pjesë e një regresi më të gjerë demokratik dhe institucional, ku të drejtat e grave po humbasin prioritet në agjendat publike.

Ato paralajmërojnë se kur hapësira feministe dobësohet financiarisht, politikisht dhe në ambientin social, humbet edhe kapaciteti për t’i mbrojtur të drejtat e fituara, për t’i zbatuar ligjet ekzistuese dhe për të siguruar drejtësi për gratë dhe vajzat. Pikë-



isht kjo ndarje mes kornizave ligjore dhe realitetit në terren është ajo që po shohim edhe në Kosovë: ligje që ekzistojnë, por struktura mbështetëse që po dobësohen; angazhime në letër, por mungesë burimesh për t’i bërë ato funksionale.

Në këtë kontekst, strategjia dhe iniciativat e UN Women nuk janë të fokusuara në vetëm “më shumë projekte”, por në avokim për vendime të qarta politike dhe buxhetore për ta mbrojtur hapësirën feministe si interes publik dhe si parakusht për drejtësi sociale. Për vende si Kosova, ku progresi gjinor është ndërtaur me shumë mund përmes partneritetit mes institucioneve dhe shoqërisë

civile, zbehja e mbështetjes rrezikon të çojë jo vetëm në stagnim, por në kthim prapa.

Dhe kush dëshiron që të kthehet prapa? Të paktën jo një shoqëri që e ka shijuar demokracinë sikurse Kosova, ku gratë kanë avancuar; ku përfaqësimi politik është rritur; ku Konventa e Stambollit është integruar në Kushtetutë dhe ku progresi është ndërjerë thellësisht.

Momenti është kritik. Veprimet duhet të jenë të menjëhershme dhe të fuqishme për të mos ia hapur derën regresit.

Autorja është shefe e Zyrës së UN Women në Kosovë.

Hapësira feministe është hapësirë qytetare



Nermin Mahmuti

Investimi në komunitete dhe mbështetja institucionale për zërat kritikë janë veprime thelbësore feministe

Krizat e shumëfishta dhe nevoja për feminizëm

Në kohë krizash të shumëfishta – ekonomike, sociale dhe politike – hapësira feministe nuk tkurret vetëm për shkak të mungesës së vullnetit për barazi. Ajo tkurret kur dobësohet hapësira qytetare, kur delegitimohet shoqëria civile, kur aktivizmi etike-tohet si i panevojshëm ose si “agjendë e importuar” dhe kur temat që prekin drejtpërdrejt jetën e grave konsiderohen dytësore përballë “prioriteteve më të mëdha”.

Krizat nuk janë neutrale nga pikë-pamja gjinore; ato thellojnë pabarazitë ekzistuese. Rritja e çmimeve, pasiguria në punë, mungesa e mbështetjes sociale dhe barra e shtuar e kujdesit – të gjitha këto prekin gratë në mënyrë disproporcionale. Në këtë kontekst, feminizmi nuk është luks ideologjik – është nevojë strukturore.

Nga komuniteti te politika publike

Përvoja jonë si organizatë që punon për fuqizimin e komuniteteve tregon se hapësira feministe ndërtohet nga poshtë-lart. Ajo fillon në hapësira të sigurt, ku gratë ndajnë përvoja dhe artikulojnë nevojat shpesh të heshtura.

Mbështetja e grupeve për menopauzën është një shembull i qartë. Në një shoqëri ku shëndeti i grave në fazat e ndryshmeve shpesh injorohet ose trivializohet, krijimi i hapësirave të strukturuar për diskutim, mbështetje psikologjike dhe informim profesional është akt thelbësor feminist. Ai e zhvendos menopauzën nga sfera e turpit individual në diskurs publik për shëndet dhe dinjitet.

Këto grupe nuk janë thjesht aktivitete sociale. Ato janë forma organizimi që krijojnë solidaritet, rrisin vetëdijen dhe, në disa raste, shërbejnë si pikënisje për rekomandime konkrete për politika më të ndjeshme gjinore në sistemin shëndetësor. Kam parë nga afër se investimi në këto iniciativa – jo vetëm financiarisht, por edhe përmes mbështetjes institucionale dhe krijimit të partneriteteve me profesionistë dhe institucione – krijon efekt shumë më të gjerë sesa vetë aktiviteti. Ai normalizon diskutimin për shëndetin e grave si çështje publike.

Shëndeti mendor: një dimension feminist

Në kohë krize ekonomike dhe pasigurie sociale shëndeti mendor

është një nga fushat më të prekura. Gratë shpesh mbajnë barrë të shumëfishtë: punë të paguar, punë të papaguar, kujdes për familjen dhe presion social për përmbushjen e roleve tradicionale.

Iniciativat për mbështetje psikosociale, punëtoritë për mirëqenie mendore dhe fushatat për de-stigmatizimin e problemeve të shëndetit mendor janë pjesë e një qasjeje më të gjerë për drejtësi sociale. Ato sfidojnë idenë se shëndeti mendor është çështje individuale, duke e vendosur atë në kontekst të kushteve strukturore: pasiguri ekonomike, diskriminim dhe mungesë shërbimesh.

Mbështetja e këtyre iniciativave dhe integrimi i perspektivës gjinore në programet për shëndetin mendor është pjesë e një vizioni për komunitete më të qëndrueshme. Sepse qëndrueshmëria nuk është vetëm ekonomike; është edhe emocionale dhe sociale.

Të drejtat e punës dhe dinjteti ekonomik

Një tjetër dimension i hapësirës feministe është tregu i punës. Gratë në Kosovë ende përballen me pjesëmarrje të ulët në tregun formal, pabarazi pagash dhe kushte të pasigurt pune.

Aktivitetet që promovojnë të drejtat e punës, që rrisin ndërgjegjësimin për standardet ligjore dhe mbështesin organizimin kolektiv janë forma konkrete të

feminizmit në veprim. Ato adresojnë dimensionin ekonomik të barazisë, jo vetëm përfaqësimin, por qasjen reale në burime dhe siguri.

Mbështetja për studime dhe dokumente politike mbi çështjet e punësimit të grave, ndikimin gjinor të politikave ekonomike dhe boshllëqet në zbatimin e legjislacionit të punës janë po aq të rëndësishme. Hulumtimi i bazuar në fakte krijon terren për avokim të strukturuar dhe politika më të drejta.

Nga përvoja ime besoj se investimi në studime, analiza dhe rekomandime politike është gjithashtu i rëndësishëm sa mbështetja e aktiviteteve në terren. Pa këto, kërkesat për ndryshim mbeten të brishta përballë diskurseve populiste.

Llogaridhënia si mbrojtje e barazisë

Në thelb të të gjitha këtyre iniciativave qëndron një parim: llogaridhënia. Kur institucionet janë transparente politikat bazohen në analiza serioze dhe komunitetet kanë zë në vendimmarrje, krijohet hapësirë më e sigurt për avancimin e barazisë gjinore.

Populizmi shpesh përpiqet ta paraqesë barazinë gjinore si luks ose shpërqendrim nga “problemet reale”. Por, problemet reale – papunësia, mungesa e shërbimeve cilësore, pasiguria ekonomike – janë thellësisht të lidhura me barazinë.

Prandaj, mbështetja e organizatave që monitorojnë politikat publike, hartojnë analiza kritike dhe

mobilizojnë qytetarët për transparencë është investim në hapësirën feministe.

Nga pjesëmarrja te transformimi

Sfida jonë nuk është vetëm rritja e pjesëmarrjes së grave, por të sigurojmë që kjo pjesëmarrje të përkthehet në ndikim real. Zërat e tyre duhet të reflektohen në politika, përvojat e tyre të njihen si burim legjitim për ndryshim institucional.

Hapësira feministe nuk ndërtohet vetëm me deklaratë. Ajo ndërtohet me struktura mbështetëse, financim të qëndrueshëm, partneritete të besueshme dhe udhëheqje që e shoh barazinë gjinore si dimension transversal të zhvillimit.

Në kohë krizash globale dhe rritjeje të populizmit është e lehtë të tërhiqemi drejt prioriteteve afatshkurtra. Por, pikërisht në këto momente duhet të jemi më të qartë se kurrë: demokracia, shëndeti mendor, të drejtat e punës, kontributi në politika dhe rekomandime – të gjitha janë pjesë e të njëjtit projekt emancipues.

Hapësira feministe nuk është e ndarë nga hapësira qytetare. Ajo është testi më i qartë i saj. Aty ku gratë kanë zë, ku organizohen, ku ndikojnë në politika dhe ku jetojnë me dinjitet, demokracia nuk është vetëm formale – është reale.

Autorja është Drejtore Ekzekutive e CDF.



Dr. Kosana Beker

Protestat masive që përfshinë Serbinë në vitin 2024, të shkaktuara nga shembja vdekjeprurëse e strehës së betonit në një stacion hekurudhor në Novi Sad, shënuan një nga momentet më të rëndësishme të mobilizimit qytetar në dekadat e fundit. Ajo që filloi si një kërkesë për llogaridhënie shpejt u shndërrua në një lëvizje më të gjerë kundër korrupsionit sistematik dhe dështimit institucional. Ndërsa studentët njiheshin gjerësisht si forca lëvizëse e protestave, gratë ishin të pranishme në çdo nivel - si organizatore, pjesëmarrëse në vijën e parë, në përkujdesje, stratege dhe simbole të rezistencës.

Të kuptuarit e këtyre protestave pa një perspektivë gjinore do të thotë të anashkalohet një dimension qendror i kuptimit të tyre politik. Pjesëmarrja e grave nuk ishte ndihmëse, por përbërëse e vetë lëvizjes. Në të njëjtën kohë, dhuna e drejtuar ndaj protestueseve nuk ishte as aksidentale dhe as e rastësishme. Ajo funksionoi si një mekanizëm kontrolli politik që synonte disiplinimin e trupave, zërave dhe pranisë së grave në hapësirën publike. Hulumtimi i FemPlatz-it: "Midis Megafonit dhe Heshtjes: Gratë në Luftën për Ndryshim", dokumenton se si gratë në të gjithë Serbinë u bënë agjente kryesore të ndryshimit shoqëror gjatë viteve 2024-2025 - jo përmes institucioneve që i marginalizojnë ato në mënyrë sistematike, por përmes veprimit kolektiv dhe solidaritetit. Ky proces mbart potencial emancipues, duke krijuar forma të reja të komunitetit politik të bazuara në besim, përgjegjësi dhe kujdes të ndërsjellë.

Dukshmëria dhe pjesëmarrja politike e grave

Që nga fillimi i protestave, gratë ishin shumë të dukshme. Plenumet studentore, bllokadat e fakulteteve, marshimet protestuese dhe vigjiljet e heshtura shpesh organizoheshin ose



Irena Cvetkovikj

Po e njetojmë fundin e botës ashtu siç e njohim. Në mbarë globin, dhe në rajonin tonë, krizat nuk janë më ndërprerje, por normaliteti i ri: pasiguri ekonomike, erozion demokratik, gjendje e përhershme emergjence dhe rishfaqje e logjikave dhe praktikave fashiste në jetën politike. Ajo që dikur dukej si përjashtim po bëhet rregull, përjashtimi normalizohet, udhëheqja autoritare legjitimohet dhe dhuna riformulohet si mbrojtje e kombit, e familjes dhe e “normalitetit”. Në një moment të tillë, lëvizjet feministe nuk mund të mbeten vetëm në një pozicion përshtatjeje. Detyra është politike: të marrin një rol udhëheqës në formësimin e kornizave të horizonteve të reja politike në zhvillim. Lëvizjet feministe janë të pajisura në mënyrë unike për këtë detyrë. Feminizmi ka përvojë të gjatë në njohjen e shenjave të hershme të përjashtimit, dhunës dhe rrëshqitjes autoritare. Ai mbart një traditë të pasur mbijetese dhe rezistence, si dhe zotëron njohuri për mënyrën e transformimit si të marrëdhënieve intime, ashtu edhe të atyre strukturore të pushtetit.

Ky normalitet i ri, i strukturuar nga politika transaksionale si forma dominuese e dialogut, nga shfrytëzimi si logjika kryesore e pushtetit dhe nga figura e udhëheqësit “të fortë” si subjekti i saj ideal, kërkon prej nesh një zhvendosje të vështirë, por të domosdoshme. Kërkon që të shkojmë

Gratë në vijat e para

koordinoheshin nga gratë. Gratë e reja lehtësuan diskutimet, menaxhuan logjistikën, komunikuan me komunitetet lokale dhe formësuan tonin etik të lëvizjes. Shumë pjesëmarrës përshkruan se si pritej që gratë t'i "mbanin gjërat në rend" - për të siguruar kujdes, qetësi dhe vazhdimësi - ndërsa njëkohësisht merrnin rreziqe në vijën e parë.

Kjo dukshmëri sfidoi supozimet mbizotëruese rreth asaj se kush ka të drejtë të flasë, të udhëheqë dhe të protestojë. Ajo prishi rolet e rrënjësura gjinore që i kufizojnë gratë në hapësira mbështetëse ose private, si dhe i vendosi ato në mënyrë të fuqishme në arenën politike. Megjithatë, dukshmëria solli gjithashtu edhe rritje të cënueshmërisë. Ndërsa gratë morën role udhëheqëse dhe u angazhuan në mosbindje kolektive, ato u bënë caqe specifike të frikësimit dhe dhunës.

Format e shumëfishta të dhunës me bazë gjinore

Dhuna me bazë gjinore mori forma të shumëfishta gjatë protestave. Gratë raportuan sulme fizike nga sulmues të paidentifikuar ose policë, ngacmime verbale mizogjine, kërcënime për dhunë seksuale dhe abuzim të vazhdueshëm në internet që synonin poshtërimin dhe heshtjen. Disa incidente në të cilat gratë pësuan lëndime serioze u bënë emblematike të shtypjes me të cilën u përballën protestuesit. Këto akte u kuptuan gjerësisht jo si teprime të izoluara, por si paralajmërime të qëllimshme - veçanërisht për gratë - për pasojat e rezistencës.

FemPlatz dokumentoi 67 incidente dhune që prekën 110 gra midis nëntorit 2024 dhe janarit 2026. Më shumë se gjysma e këtyre grave pësuan lëndime fizike, shpesh për shkak të përdorimit të tepërt të forcës nga policia. Në shumicën e rasteve, gratë përjetuan forma të shumëfishta dhune njëkohësisht, duke përfshirë abuzimin fizik, seksual, psikologjik dhe digjital. Gratë që folën publikisht për përvojat e tyre ishin veçanërisht të ekspozuara ndaj ngacmimit të zgjatur në internet. Në këtë kontekst, dhuna me bazë gjinore funksionoi si një strategji politike: ajo

kërkoj të rivendoste kontrollin patriarkal në momentet kur gratë e prishën atë kolektivisht.

Solidariteti – gratë që përkrahin gratë

Pavarësisht frikës dhe rrezikut, dhuna nuk solli tërheqje. Në vend të kësaj, shumë gra përshkruan se si ajo i forcoi lidhjet e solidaritetit. Gratë mbrojtën njëra-tjetrën gjatë protestave, formuan rrjete joformale sigurie, ndanë informacione rreth rreziqeve, shoqëruan njëra-tjetrën në shtëpi dhe ndërhyjnë në momente kërcënimi ose ngacmimi. Solidariteti ishte praktik, i mishëruar dhe i menjëhershëm.

Ky solidaritet ishte gjithashtu thellesisht politik. Në një kontekst ku institucionet dështuan të ofronin siguri ose drejtësi, gratë krijuan sistemet e tyre të mbrojtjes dhe kujdesit. Ato e refuzuan izolimin - efektin kryesor që dhuna kërkon të arrijë - dhe e transformuan cënueshmërinë në forcë kolektive. Shumë gra deklaruan që solidariteti ishte arsyeja kryesore pse ato vazhduan të protestonin pavarësisht frikës. Është e rëndësishme të theksohet se ky solidaritet nuk e romantizoi vuajtjen. Pjesëmarrëset folën hapur për lodhjen, ankthin dhe tendosjen emocionale, duke sfiduar kulturat që i japin përparësi qëndrueshmërisë mbi kujdesin. Solidariteti u bë një praktikë feministe e rezistencës që mundësoi angazhim të qëndrueshëm në vend të lodhjes heroike.

Organizatat e shoqërisë civile, grupet feministe dhe aktivistet luajtën rol vendimtar duke ofruar ndihmë ligjore, mbështetje psikologjike, vendosje në raste emergjente dhe ndihmë për sigurinë fizike dhe digjitale, ndërkohë që dokumentuan shkeljet dhe hartuan raporte. Në të njëjtën kohë, mbrojtëset e të drejtave të njeriut dhe feministet që mbështesin të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe shtypjes shtetërore ishin vetë të ekspozuara ndaj kërcënimeve dhe sulmeve të vazhdueshme. Ky realitet nënvizon një të vërtetë më të gjerë: në Serbinë e sotme, barazia gjinore përparohet më shumë përmes lëvizjeve joformale dhe aktivizmit, sesa përmes institucioneve shtetërore.

Rishpikja feministe në normalitetin e ri


përtej idesë së hapësirave feministe thjesht si hapësira të sigurta. Kjo mund të ndihet shqetësuese, madje e pakëndshme. Megjithatë, është edhe një hapje: një moment tjetër historik në të cilin lëvizjet feministe thirren të rimendojnë veten. Për dekada, hapësirat e sigurta kanë qenë vende kryesore mbrojtjeje nga dhuna, heshtja dhe përjashtimi, hapësira ku përvojat e marginalizuara mund të artikuloeshin, të ndaheshin dhe të politizoheshin. Por, kur siguria përkufizohet si të qenit vetëm mes atyre që mendojnë, ndajenë dhe flasin si ne, ajo rrezikon të prodhojë mbyllje në vend të zgjerimit, rehati në vend të transformimit. Politika nuk lind nga njëtrajtshmëria, por nga takimi, nga grindja, mosmarrëveshja dhe mundësia për t'u ndryshuar nga të tjerët. Një hapësirë që vetëm na mbrohet nga bota nuk mund ta transformojë botën. Përballë autoritarizmit dhe rikthimit të logjikave fashiste, hapësirat feministe duhet të mbeten hapësira kujdesi, por duhet gjithashtu të bëhen hapësira veprimi: të hapura ndaj takimit, të afta për konflikt dhe të orientuara drejt ndërhyrjes politike kolektive.

Kufijtë e sigurisë duhet të emërtohen qartë. Kur siguria përkufizohet si mungesë mosmarrëveshjeje, si të qenit vetëm mes atyre që ndajnë të njëjtën gjuhë, qëndrime dhe ndjeshmëri, ajo prodhon një homogjenitet mendimi që është politikisht kufizues. Hapësirat feministe rrezikojnë të bëhen vende ku qëndrimet tashmë të përbashkëta përsëriten në vend që të vihen në pikëpyetje, ku siguria zëvendëson kureshtjen dhe ku mbyllja zë vendin e zgjerimit. Pa

takim nuk ka transformim, pa grindje nuk ka rishikim të supozimeve tona. Politika nuk lind vetëm nga rehatia. Ajo kërkon ekspozim ndaj dallimit, mundësi të konfliktit dhe gatishmëri për t'u shqetësuar. Një feminizëm që flet vetëm me veten rrezikon të humbasë si avantazhin e tij kritik, ashtu edhe kapacitetin transformues.

Megjithatë, kufijtë e sigurisë nuk janë vetëm të brendshëm. Ata prodhohen edhe nga jashtë, përmes sulmeve sistematike ndaj hapësirave feministe nga akterë populistë dhe antigjinorë. Në të gjithë rajonin dhe globalisht, organizatat feministe portretizohen si të huaja, elitiste, kundër familjes, apo madje të rrezikshme për shoqërinë. Puna e tyre delegjitimohet, financimi vihet në dyshim, dija e tyre diskreditohet dhe vetë aktivistet shënjestrohen me ngacmime dhe dhunë. Në një kontekst të tillë, tërheqja në hapësira të izoluara të njëtrajtshme nuk është një strategji e qëndrueshme. Ajo i lë lëvizjet feministe politikisht të izoluara dhe më të lehta për t'u sulmuar. Vala aktuale e autoritarizmit dhe rikthimi i logjikave fashiste e bëjnë të qartë: transformimi i hapësirave feministe nuk është një ushtrim teorik, por një domosdoshmëri politike. Për të mbetur relevante dhe efektive, këto hapësira duhet të bëhen të orientuara nga jashtë, relacionale dhe strategjike, të afta jo vetëm për mbrojtje, por për ndërhyrje, ndërtim aleancash dhe veprim kolektiv.

Kufijtë e sigurisë nuk mund të kuptohen jashtë rikonfigurimit më të gjerë neoliberal të politikës feministe. Gjatë dekadave të fundit, shumë



Format feministe të rezistencës

Protestat prodhuan gjithashtu forma feministe të rezistencës që largoheshin nga hierarkitë tradicionale politike. Vendimmarrja ishte kryesisht horizontale, bazuar në plenumet dhe pjesëmarrje kolektive. Nuk kishte udhëheqës zyrtar: legjitimiteti doli përmes angazhimit dhe jo autoritetit. Vetë heshtja u bë një akt i fuqishëm politik, veçanërisht gjatë momenteve kolektive të qetësisë në nderim të viktimave në Novi Sad. Gratë luajtën një rol qendror në formësimin e këtyre praktikave, duke ripërcaktuar rezistencën që të përfshinte kujdesin, këmbënguljen, përgjegjësinë e ndërsjellë dhe refuzimin për të riprodhuar dhunën.

Në të njëjtën kohë, protestat zbuluan tensione të vazhdueshme. Ndërsa gratë ishin të domosdoshme për lëvizjen, kërkesat e tyre specifike - veçanërisht në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe pabarazinë strukturore - nuk ishin gjithmonë të integruara plotësisht në agjendën më të gjerë politike. Pranimi i këtij boshllëku është thelbësor. Pa e trajtuar pabarazinë gjinore si një çështje thelbësore politike, kërkesat për drejtësi dhe llogaridhënie mbeten të paplota.

Transformimi i rezistencës

Ndryshimet shoqërore dhe politike në Serbi janë bërë një hapësirë për zbatimin dhe mësimin e demokracisë në praktikë. Përmes komunitetit, solidaritetit dhe veprimit publik, gratë fitojnë përvojë politike dhe vetëbesim dhe krijojnë forma të reja dhe jointucionale të komunitetit politik.

Përvojat e grave në protestat e 2024-2025 në Serbi tregojnë se gjinia nuk është një shqetësim marginal në kohë krize politike. Ajo formëson ekspozimin ndaj dhunës, format e shtypjes dhe mundësitë për rezistencë. Gratë nuk morën pjesë thjesht në protesta - ato i transformuan ato. Duke këmbëngulur në prani pavarësisht dhunës, duke e shndërruar solidaritetin në strategji dhe duke përfshirë vlerat feministe në praktikën e përditshme politike, ato zgjeruan imagjinatën politike të veprimit kolektiv në Serbi.

Autorja është drejtore programi në Shoqatën e Grave FemPlatz, aktiviste e kahershme për të drejtat e grave dhe feministe.

tij një kuptim të dyfishtë: nga greqishtja krisis - një moment vendimi, një pikë kthese, një çarje që kërkon gjykim dhe veprim. Kriza nuk është kurrë vetëm një fund. Ajo është edhe një hapje. Kjo është arsyeja pse imagjinata bëhet thelbësore në momente të tilla, dhe veçanërisht imagjinata politike, jo si praktikë arratisjeje apo ëndërrimi me sy hapur, por si metodë: si aftësi për të përfytyruar alternativë, për t'i rikonfiguruar koordinatat e së mundshmes dhe për të vepruar sikur një e ardhme e ndryshme mund të ndërtohet. Lëvizjet feministe e kanë praktikuar prej kohësh këtë lloj imagjinatë - në historitë e tyre, zemërimet e tyre, refuzimet e tyre dhe eksperimentet me mënyra të tjera të të jetuarit së bashku. Në kohë të shënuara nga frika, mbyllja dhe rrëshqitja autoritare, imagjinata nuk është luks: ajo është një mjet politik i domosdoshëm. Dhe bashkë me të, shpresë. Jo optimizëm, jo mohim i krizës, por një orientim drejt së ardhmes i mbështetur në qëllim dhe përpjekje, një vendim për të vepruar drejt një horizonti të ndryshëm edhe kur kushtet janë të pafavorshme. Politika feministe gjithmonë ka ditur ta mbajë një shpresë të tillë brenda pesimizmit, pa rënë në optimizëm të dhunshëm, duke mbajtur së bashku kthjellëtesinë për të tashmen dhe përkushtimin ndaj transformimit. Në këtë kuptim, rishpikja feministe sot nuk është vetëm një përgjigje ndaj krizës, por një metodë për të hapur të ardhmen.

Autorja është hulumtuese feministe e pavarur.

A ka një hapësirë të sigurt për vajzat adoleshente?

Blenda Asllani

Adoleshenca si periudhë e cënueshme

Adoleshenca është një nga fazat më të rëndësishme të zhvillimit njerëzor, e karakterizuar nga transformime të shumta biologjike, sociale dhe kognitive. Studiuesit bien dakord se kjo periudhë është themelore për formësimin e identitetit personal, zhvillimin e vetëbesimit, aftësive sociale dhe mënyrave të krijimit të marrëdhënieve. Erik Erikson, një nga teoricienët më të rëndësishëm të zhvillimit, e përkuvizon adoleshencën si fazën e “identitetit kundrejt konfuzionit”, ku të rinjtë ndërtojnë kuptimin e vetes përmes eksperiencave, sfidave dhe marrëdhënieve që krijojnë.

Kjo nënkupton se përvojat që vajzat kalojnë në këtë fazë kanë ndikim afatgjatë në shëndetin e tyre mendor, emocional dhe fizik. Përjetimet e dhunës, në veçanti, mund të ndikojnë në zhvillimin e identitetit, në ndërtimin e vetëbesimit dhe në krijimin e marrëdhënieve të ardhshme.

Vajzat adoleshente përbëjnë një nga grupet më të cënueshme ndaj dhunës në nivel global. Sipas vlerësimeve të fundit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (2025), dhuna ndaj vajzave fillon herët dhe

rreziqet vazhdojnë përgjatë gjithë jetës. Vetëm në vitin 2023, rreth 12.5 milionë vajza të moshës 15-19 vjeç kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim. Raportet e UNESCO (2020) dhe UN Women (2024) theksojnë se vajzat janë në rrezik të lartë për ngacmim seksual në shkollë, bullizëm, dhunë në internet, si dhe kontrollim apo abuzim psikologjik në marrëdhëniet e para romantike.

Një faktor kyç që e thallon cënueshmërinë e adoleshenteve është mënyra se si shoqëria e trajton dhunën që ato përjetojnë. Shpesh, përvojat e vajzave minimizohen apo trajtohen si normale në raport me shokët/shoqet apo familjarët.

Fajësimi i viktimave, frika, turpi dhe mungesa e mbështetjes nga familja dhe institucionet e nxisin ciklin e heshtjes dhe mosraportimit. Shumë vajza që tentojnë të kërkojnë ndihmë hasin në mosbesim, gjykim apo procedura të komplikuar burokratike që nuk i marrin parasysh nevojat e moshës së tyre.

Prandaj, adoleshenca mbetet një periudhë në të cilën dhuna ka ndikim më të thellë sesa në çdo fazë tjetër të jetës. Ajo formëson mënyrën si vajzat e shohin veten, trupin e tyre dhe botën përreth, dhe mënyra se si reagojnë të rriturit dhe institucionet ndaj dhunës në këtë moshë përcakton kufijtë e sigurisë me të cilët do të rriten gjeneratat e ardhshme.

Vajzat përballen me dhunë në çdo hapësirë ku kalojnë kohën

Dhuna ndaj vajzave adoleshente ka shtrirje strukturore dhe gjendet kudo ku janë vajzat, duke u shfaqur në forma të ndryshme dhe duke i kushtëzuar mënyrat si ato e perceptojnë sigurinë, trupin dhe veten.

Disa vajza janë edhe më të cënueshme ndaj dhunës me bazë gjinore - veçanërisht vajzat rome dhe ato nga komunitetet tjera të marginalizuara, vajzat queer, dhe vajzat me aftësi të kufizuara, të cilat përballen me diskriminim shumëfish të shtresëzuar.

Në familje, vajzat shpesh përjetojnë dhunë psikologjike, emocionale dhe fizike, si dhe kontrole të rrepta mbi sjelljen, veshjen dhe lëvizjet e tyre. Kjo dhunë, në të shumtën e rasteve, relativizohet si “disiplinë” apo “kujdes prindëror”, duke u mohuar vajzave të drejtën për ambient të sigurt brenda shtëpisë.

Në shkollë, ato përballen me bullizëm, ngacmime seksuale nga bashkëmoshatarët ose të rriturit, presion social, komente për trupin dhe seksualizim të hershëm. Këto forma dhune shpesh justifikohen si “normale mes shokësh”.

Në rrugë, adoleshentet përballen me ngacmime seksuale, përndjekje, komente të padëshiruara dhe objektivizim. Për vajzat as hapësirat publike nuk janë neutrale - rruga,

autobusi, parku - shndërrohen në vende ku trupat e tyre vëzhgohen, komentohen dhe kontrollohen.

Interneti, ku vajzat dhe djemtë kalojnë pjesën më të madhe të kohës dhe kërkojnë të afirmohen, është shndërruar në një hapësirë të re ku ushtrohet dhunë ndaj vajzave dhe grave. Kjo dhunë merr forma të ndryshme, nga ngacmimet seksuale, te shpërndarja e paaautorizuar e imazheve, shantazhi dhe gjenerimi i imazheve përmes “deepfake”, si dhe fshihet shumë lehtë përmes anonimitetit dhe qarkullimit të shpejtë të përmbajtjes online.

Dhuna ndaj adoleshenteve nuk mund të kuptohet ndryshe përveçse si fenomen shumë i përhapur, i cili krijon një cikël të përsëritur rreziku në çdo hapësirë ku vajzat rriten, ndërveprojnë dhe formësojnë identitetin e tyre.

Mungesa e edukimit seksual dhe informimit për trupin

Një ndër problemet më të mëdha që e rrit cënueshmërinë e adoleshenteve është mungesa e edukimit seksual dhe riprodhues në shkollë. Në shumë sisteme arsimore, përfshirë Kosovën dhe vendet e rajonit, fëmijët nuk marrin informacion të sigurt, të saktë dhe të bazuar në evidencë përmes kurrikulave arsimore, dhe kështu mbeten pa njohuri thelbësore për pëlqimin, ndryshimet

hormonale që përjetojnë gjatë adoleshencës, ciklin menstrual, zhvillimin e trupit, marrëdhëniet seksuale të mbrojtura dhe të drejtat e tyre.

Mungesa e edukimit seksual dhe riprodhues prodhon një gjeneratë vajzash që shpesh nuk arrijnë t'i emërtojnë përvojat e dhunës, sepse nuk e dinë çfarë është pëlqimi, çfarë përbën shantazh seksual, çfarë konsiderohet ngacmim, apo cilat sjellje janë abuzive, si dhe u pamundëson që të identifikojnë situata të rrezikshme dhe që të kërkojnë ndihmë në kohë. Njëkohësisht, kjo mungesë prodhon një gjeneratë djemsh që normalizojnë sjellje të dhunshme, kontrolluese ose abuzive, sepse këto u prezantohen si norma shoqërore të të qenit djalë apo burrë.

Ndikimi afatgjatë i dhunës me bazë gjinore gjatë adoleshencës

Dhuna e përjetuar në adoleshencë nuk zhduket me moshën, ajo përjetësohet në mënyrën se si vajzat shohin botën dhe veten. Kur dhuna normalizohet që në moshë të re, ajo pranohet më lehtë në marrëdhëniet e ardhshme: vajzat që rriten me ndjenjën se kontrolli, xhelozia, frikësimi apo poshtërimi “janë normale”, kanë më pak mundësi të vënë kufij të shëndetshëm në të ardhmen.

Studime të shumta, si UNICEF (2014) dhe OBSH (2022), tregojnë se dhuna në adoleshencë lidhet me rritje të niveleve të depresionit, ankthit, çrregullimeve të stresit post-traumatik, si dhe me rrezik më të lartë për dhunë të ripërsëritur në moshat e mëvonshme.

Dështimet institucionale dhe shoqërore

Një dimension kritik i kësaj çështjeje është dështimi i institucioneve dhe i shoqërisë për t'i mbrojtur vajzat adoleshente. Policia, institucionet arsimore, shërbimet sociale dhe shëndetësore shpesh nuk kanë mekanizma efektivë për parandalimin, identifikimin dhe trajtimin e dhunës ndaj vajzave të reja.

Në shumë raste, vajzat adoleshente nuk shihen si viktime të dhunës, sepse të rriturit vazhdojnë të mos i njohin të miturat/fit si qytetarë të barabartë që meritojnë mbrojtje. Duke qenë se shoqëria nuk i trajton vajzat adoleshente si subjekte të plota të të drejtave, ajo nuk i percepton as si viktime të dhunës me bazë gjinore, gjë që u mohon atyre qasjen në drejtësi, mbrojtje dhe mbështetje.

Në një klimë të tillë, dhuna bëhet dështim kolektiv shoqëror e shtetëror për të garantuar sigurinë dhe dinjitetin e vajzave.

Përballë këtyre dështimeve strukturore ku institucionet dhe shoqëria vazhdojnë të dështojnë në mbrojtjen e adoleshenteve, hapësirat feministe mbeten të domosdoshme, përveçse të rëndësishme, sidomos në Kosovë, ku organizatat e grave dhe grupet joformale feministe shpesh janë vendet e para, e ndoshta të vetmet, ku vajzat marrin informacion të verifikuar, të besueshëm dhe të sigurt për trupin, të drejtat dhe përvojat e tyre. Këto hapësira krijojnë ambiente ku vajzat mund të flasin pa frikë, të ndjejnë përkatësi dhe të artikulojnë dhunën që kanë përjetuar.

Është qenësore që institucionet të njohin shkallën e cënueshmërisë së adoleshenteve, format dhe prevalencën e dhunës ndaj tyre, dhe t'i angazhojnë të gjitha palët - vetë vajzat, prindërit, shkollat, policinë dhe shërbimet sociale - në një qasje të përbashkët që e adreson problemin duke marrë parasysh moshën, realitetet dhe përvojat e tyre.

Autorja është aktiviste feministe dhe hulumtuese në IQKA.



Pse feminizmi mbetet i pakëndshëm për populistët?



Riola Kastrati

Çdo vit, dy a tri ditë para 8 Marsit, lulishtet e tezgat në Kosovë mbushen me buqeta lulesh, urime e deklarata mbi “rolin e pazëvendësueshëm të gruas në shoqëri”. Fytyrat publike shkruajnë postime, institucionet organizojnë pritje simbolike. Për një ditë, gratë vendosen në qendër të vëmendjes. Por, nëse e shohim më nga afër këtë ritual të përvitshëm, lind një pyetje e domosdoshme: çfarë po ndodh me gratë dhe me kërkesat feministe përtej simbolikave?

Në shumicën e rasteve, përgjigjja është e thjeshtë: ato bëhen nga agjenda politike. Kjo mungesë e përfaqësimit të grave e interesave të tyre nuk është rastësi. Ajo lidhet me një tension më të thellë mes feminizmit dhe një forme politike që është bërë gjithnjë e më e pranishme në shumë shoqëri, përfshirë edhe Kosovën: populizmit.

Populizmi e ndërton politikën mbi një ndarje të thjeshtë: “populli i ndershëm” kundër “elitave të korruptuara”. Në këtë narrativë, populli paraqitet si një trup i bashkuar, me interesa të përbashkëta dhe një moral të qartë. Problemi është se ky imazh i një populli homogjen rrallë lë hapësirë për t'i diskutuar pabarazitë që ekzistojnë brenda vetë popullit. Mungesa e hapësirës është pikërisht pika ku fillon tensioni me feminizmin.

Feminizmi nuk e sheh shoqërinë si një komunitet harmonik. Ai e bën të dukshme se edhe brenda “popullit” ekzistojnë struktura pushteti. Patriarkati, dhuna gjinore, pabarazitë ekonomike janë vetëm disa ndër to e që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e grave e më gjerë. Në këtë kuptim, feminizmi prish mitin e një populli të bashkuar dhe të barabartë.

Në Kosovë ky tension merr formë e shfaqet në mënyra të ndryshme. Nga njëra anë, gratë shpesh përdoren si simbol moral i shoqërisë: si nëna sakrifikuese, si mbajtëse të familjes, si figura të qëndresës. Diskursi publik shpesh e lavdëron gruan si shtyllë të kombit, si zemër të familjes, si forcë morale të shoqërisë. Por ky portretizim nuk përkethehet domosdoshmërisht në pushtet real, apo në transformim strukturor.

Kosova shpesh përmendet si shembull pozitiv për përfaqësimin e grave në politikë, falë kuotës gjinore në parlament. Dhe është e vërtetë që prania numerike e grave është më e lartë se në shumë vende të rajonit. Por përfaqësimi numerik nuk barazohet me fuqinë politike.

Në shumë raste, gratë në politikë pritet të jenë përfaqësues simbolike të barazisë, por jo domosdoshmërisht aktore që e sfidojnë strukturën e pushtetit. Diskursi për barazi shpesh reduktohet në statistika, sa gra janë në parlament e sa në qeveri. Pyetjet feministe në thelb mbeten anash: Kush i merr vendimet? Kush e kontrollon agjendën? Cilat politika konsiderohen prioritare?

Andaj lëvizjet feministe shpesh dhe me të drejtë qëndrojnë në tension e cilësohen të pakëndshme nga politikatat populiste. Lëvizjet feministe nuk

mjaftohen me simbolikë.

Kur aktivistet/ët mbushin rugët e Kosovës me protesta kundër dhunës ndaj grave, kundër femicideve, apo kundër trajtimeve të padinjitetshme, ato/a nuk po flasin vetëm për raste individuale. Ato/a po vënë në pikëpyetje struktura të tëra shoqërore: mënyrën se si funksionon sistemi i drejtësisë, mënyrën se si trajtohen viktimat, mënyrën se si normalizohet dhuna në familje dhe në shoqëri. Këto janë pyetje që nuk mund të zgjidhen vetëm me lule e postime.

Në të njëjtën frymë, marshet e 8 Marsit nuk janë thjesht aktivitete simbolike, por hapësira ku artikullohet një kritikë më e thellë ndaj institucioneve dhe ndaj kulturës patriarkale. Parullat e protestuesve shpesh janë të drejtpërdrejta, domosdoshmërisht edhe të ashpër – sepse ato reflektojnë pakënaqësitë e grave që përballen me një realitet ku dhuna dhe diskriminimi vazhdojnë të jenë të përhapura.

Në këtë kuptim, feminizmi nuk është një projekt elitist apo i importuar nga jashtë, siç pretendohet shpesh në diskursin publik. Ai është një përgjigje ndaj përvojave të grave në shoqërinë tonë.

Është e zakonshme që kërkesat feministe të etiketohen si “agjendë e huaj”, apo si diçka që nuk i përfaqëson “vlerat e popullit”. Kjo strategji retorike është e njohur në shumë kontekste populiste: çdo kritikë ndaj strukturave ekzistuese paraqitet si kërcënim ndaj identitetit kolektiv.

Megjithatë, feminizmi nuk është kundër popullit. Ai është kundër padrejtësive brenda popullit.

Ai nuk e mohan solidaritetin shoqëror, por kërkon që ky solidaritet t'i përfshijë edhe gratë e të



gjithë personat e diskriminuar – jo vetëm si simbol, por si qytetare/ë me të drejta të plota. Ai nuk e kundërshton idenë e komunitetit, por refuzon një komunitet që ndërtohet mbi heshtjen e pabarazive.

Kjo është arsyeja pse feminizmi shpesh është i pakëndshëm: ai kërkon më shumë se sa njohje simbolike. Ai kërkon ndryshim.

Autorja është aktiviste feministe.

Veprimi feminist për realizimin e të drejtave sociale e ekonomike



Nerina Guri

Me zgjerimin e frymës së djathtë populiste dhe lëvizjes anti-gjinore, zvogëlimin e mbështetjes financiare për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe ndryshimin e prioriteteve globale gjeopolitike, organizimi dhe veprimi feminist bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm. Organizatat për të drejtat e grave mbeten faktor vendimtar për demokraci funksionale, mbrojtje të të drejtave të njeriut, ofrim të shërbimeve sociale, mbajtjen e rendit të ligjit dhe adresimin e pabarazive gjinore. Megjithatë, shumë prej këtyre organizatave janë përballur me sfida të shtuara për vazhdimin e punës së tyre dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Me përkeqësimin e situatës së mbështetjes së të drejtave të grave në kontekst global dhe të Kosovës, është e rëndësishme që barazia gjinore të jetë pjesë përbërëse e prioriteteve të tjera gjeopolitike. Pabarazitë gjinore në Kosovë e bëjnë organizimin feminist edhe më thelbësor drejt drejtësisë sociale dhe transformimit të normave gjinore.

Sipas Organizatës për të Drejtat e Grave në Zhvillim (AWID), 99% e granteve për fondacione dhe ndihmës për zhvillim nuk janë të qasshme dhe 0.13% të financimit total nga Asistenca Zyrtare për Zhvillim (ODA). Organizatat që punojnë me grupe të komunitetit LGBTQIA+,

migrantë, dhe të etnive të ndryshme, pranojnë edhe më pak mbështetje financiare. Në Ballkanin Perëndimor organizatat e angazhuara për shërbime ndaj grave me aftësi të kufizuara, apo ato në zona rurale, kishin mesatarisht rreth shtatë herë më pak të hyra vjetore se organizatat tjera. Këta trendë janë shqetësues meqenëse e zvogëlojnë ofrimin e shërbimeve sociale dhe qasjen në to, edhe pse ato janë të nevojshme për një jetesë të dinjitetshme.

Në Kosovë, sipas një studimi nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RRGK) me 140 organizata për të drejtat e grave, financimi në dy vitet e fundit ka rënë për rreth 40% prej tyre, 59% nuk kanë fonde për 2026, dhe 88% kanë raportuar si nevojën më të madhe të tyre mbështetjen financiare. Rreth 91% prej organizatave për të drejtat e grave kanë raportuar se do t'i vazhdojnë aktivitetet e tyre, ndonëse kanë mungesë të fondeve. Kjo vjen si rrjedhojë e vlerave inherente si solidariteti dhe gjithëpërfshirja, si dhe karakteristikave të lëvizjes feministe, si reziliencia dhe qasja ndërthurëse. Pavarësisht ndryshimit të prioriteteve globale gjeopolitike është qenësore që të mos cenohet ofrimi i shërbimeve sociale dhe të sigurohet financimi i qëndrueshëm afatgjatë i këtyre organizatave, duke marrë parasysh përvojën dhe ekspertizën e tyre.

Aq më tepër që nga ana tjetër synimet për barazi gjinore janë të ndërlidhura me të gjitha sferat e tjera të mundshme të prioriteteve gjeopolitike. Për shembull, rritja e financimit global në sektorin e sigurisë pa përfshirje të një perspektive gjinore dhe të shoqërisë civile i dëmton arritjet progresive të deritanishme për funksionimin demokratik të shteteve. Mospërfshirja e barazisë gjinore në proceset e sigurisë dhe shtetndërtimit e cenon efektivitetin dhe legjitimitetin

e këtyre proceseve. Pa një qasje sensitive gjinore në politika të sigurisë dhe pjesëmarrje aktive të grave në procese të vendimmarrjes krijohen struktura të pabarabarta dhe përjashtuese që nuk i marrin parasysh nevojat e të gjithëve.

Gjithashtu, barazia gjinore është në vetvete pjesë e objektivave të tjera për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm që promovon drejtësi dhe kontribuon në mbrojtje të ambientit. Një studim empirik për shtatë ekonomi të zhvilluara tregon që investimi në infrastrukturë sociale, duke përfshirë shërbimet e kujdesit, sjell përfitime në shumë sfera të ndërlidhura: rritje të punësimit të grave përmes rritjes së kërkesës për shërbime të kujdesit, rritje të punësimit të burrave në mënyrë indirekte përmes ndërimit të objekteve dhe qendrave të kujdesit, mbrojtje të ambientit përmes krijimit të punëve “të gjelbra” dhe rritje ekonomike. Investimi publik në ekonominë e kujdesit do t'i zvogëlonte pabarazitë në tregun e punës dhe do të çonte në ndarje më të barabartë të punës së papaguar të kujdesit, rritje të autonomisë dhe fuqisë negociuese në shtëpi dhe transformimit gradual të normave gjinore. Kështu, institucionet mund të përdorin burimet dhe kapacitetet e tyre për të mbështetur avancimin e barazisë gjinore.

Në Kosovë, një studim në 2016 nga RRGK tregon se vetëm rreth 15.5% e fëmijëve janë në qendra të kujdesit. Më shumë se gjysma e të intervistuarve në marrëdhënie pune llogarisin në anëtarë të tjerë të familjes që t'i mbulojnë punët e kujdesit. Të gjithë të intervistuarit e papunësuar do të donin të punonin, kurse 88% prej tyre do të përdornin qendra të kujdesit po të ishin financiarisht të qasshme. Investimi në qendra të kujdesit ka potencial të krijojë vende të reja të punës për mësues/e dhe ku-

jdestarë/e, dhe të formalizojë punën e kujdesit përmes punësimit të prindërve dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes që nuk janë pjesë e tregut të punës për shkak të mungesës në ofertë të shërbimeve të kujdesit. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, pavarësisht trendit të rritjes, shkalla e pjesëmarrjes së grave në fuqi punëtore mbetet jashtëzakonisht e ulët, vetëm 25.9% në 2024. Në mënyrë konsistente më shumë gra (3.9%) sesa burra (0.7%) raportuan se arsyeja kryesore për punësim me orar të pjesshëm është për shkak të punëve të kujdesit për fëmijët, të moshuarit dhe anëtarët e familjes më aftësi të kufizuara. Vlera e punës së kujdesit të papaguar të grave në 2022 ishte rreth 2,824,248.757 euro, apo 33% e Bruto Produktit Vendor të Kosovës.

Megjithatë, diskrepanca e madhe gjinore në punët e kujdesit jo domosdoshmërisht i reflekton parapëlqimet e grave dhe burrave. Sipas një studimi të D4D në 2017, 60.4% e grave dhe 45.2% e burrave e konsiderojnë ndarjen e lejes prindërore si të dobishme për të gjithë familjen. Ndërkohë, Ligji i Punës (Nr. 03/L-212), në fuqi qysh në 2010, kontribuon në diskriminim gjinor në punësim dhe promovim nga punëdhënësit për shkak të pjesës së madhe të mbulimit të lejes së lehonisë nga punëdhënësi në raport me qeverinë. Sipas këtij ligji, leja e lehonisë mbulohet për gjashtë muaj nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës, tre muaj nga qeveria me kompensim 50% të pagës mesatare, dhe 3 muaj pa pagesë. Në këtë mënyrë, zbatimi i masës për shtesat për fëmijë, por mosdraftimi dhe mosratifikimi i një Ligji të Punës të ri që merr parasysh Direktivën e BE-së për Ekuilibrin Punë-Jetë, përfshirë lejen e atësisë dhe prindërore, si dhe Strategjinë Europiane të Kujdesit

dhe Rekomandimin për Kujdesin Afatgjatë, sjell pasoja të drejtpërdrejta në tregun e punës. Si rezultat, institucionet mirëmbajnë një treg të punës që vazhdon të jetë përforcues i pabarazive gjinore, bartës i sistemit hierarkik gjinor, përforcues i stereotipave, diskriminimit me bazë gjinore dhe normave esencialiste gjinore.

Në këto zhvillime veprimi feminist bëhet i domosdoshëm në të gjitha sferat publike, private dhe personale, nga individë, organizata civile dhe grupe të pavarura kolektive. Angazhimi feminist merr formën e: (i) ndryshimit gradual institucional përmes hulumtimit, avokimit dhe ndikimit në politikëbërje, ofrimit të shërbimeve sociale dhe përmirësimit të kushteve të punës e jetesës së grupeve të marginalizuara, (ii) anëtarësimit në sindikata dhe organizimit për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, (iii) aksionit dhe kritikës me organizimin e marsheve, grevave dhe demonstratave me fokus zhvillime lokale dhe globale, (iv) shpërbërjes së roleve gjinore nga një rrafsh personal dhe relativ me anëtarët e tjerë në shtëpi dhe me strukturat shoqërore, dhe (v) ndërgjegjësimit dhe reflektimit të materializuar në vepra, prirur nga përgjegjësia politike personale. Duke e përdorur konceptin e Sara Ahmed të Feminist Killjoy, apo Killjoy Institucionale, shpërbërja e sistemeve hierarkike gjinore, standardeve të dyfishta dhe normave konvencionale bëhet përmes reagimit ndaj këtyre strukturave. Afektet nxisin reagime dhe përpjekje kolektive për ndërtimin e hapësirave feministe në bashkëpunim gjithëpërfshirës me të tjerët, drejt realizmit të së drejtave sociale e ekonomike.

Autorja është ekonomiste feministe.

Gratë e Kosovës - shtyllë e aktivizmit në çdo periudhë



Iliriana Gashi

Për ta kuptuar lëvizjen feministe në Kosovë sot është e domosdoshme të kthehemi pas në kohë dhe të shohim kontributin e grave gjatë viteve, sidomos gjatë viteve të 1990'ta, një periudhë ndër më të vështirat për popullin shqiptar. Ishte koha e represionit politik, e mbylljes së institucioneve arsimore, kulturore dhe shëndetësore, si dhe e kufizimit të të drejtave themelore nga ana e Serbisë. Në këtë realitet të rëndë, organizimi i institucioneve të arsimit dhe shëndetësisë u bë pjesë e rezistencës paqësore dhe e mbijetesës kolektive. Gratë nuk ishin thjesht pjesëmarrëse, por shtylla kryesore në funksionimin e përditshëm të këtyre institucioneve, duke rrezikuar çdo ditë për të siguruar që popullata të mos mbetej pa dije dhe pa kujdes shëndetësor. Ky angazhim nuk ishte vetëm një akt humanitar, por edhe një formë e fuqishme rezistence politike, sepse ruajtja e arsimit dhe shëndetësisë nënkuptonte ruajtjen e dinjitetit dhe të së drejtës për ekzistencë.

Ky rol i tyre i dha lëvizjes feministe në Kosovë një bazë të fortë, sepse tregoi se barazia gjinore nuk ishte thjesht një ideal teorik, por një realitet i jetuar në praktikë, ku gratë morën përgjegjësi të barabarta me burrat në mbajtjen gjallë të shoqërisë. Ato e shndërruan guximin personal në nisma kolektive, duke hapur rrugën për brezat e

ardhshëm të aktivisteve.

Në këtë kontekst, Kosova pati gra që merreshin me politikë, me mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, që ishin profesioniste, aktiviste dhe pjesë e organizatave të ndryshme humanitare, por që kishin vizion të qartë për barazinë gjinore.

Kishte shumë gra të tilla, mirëpo me këtë rast dua ta veçoj një grua aktivizmi i së cilës ishte më ndryshe: Sazana Çapriqi, profesreshë e gjuhës angleze në Universitetin e Prishtinës dhe përkthyesë, të cilën pata fatin ta kisha edhe mike. Në vitin 1997, Sazana themeloi Shoqatën për Hulumtime dhe Botime të Gruas “Sfinga Center” dhe drejtoi revistën kulturore për studime gjinore “Sfinga”. Qëllimi i saj ishte emancipimi i gruas përmes artit, arsimit dhe fuqizimit kulturor. Organizata e vazhdoi punën edhe pas luftës, duke organizuar debate, ngjarje kulturore dhe duke promovuar mendimin kritik e afrimimin e grave në letërsi. Fatkeqësisht, Sazana u nda nga jeta shumë herët, para pesë vitesh, pikërisht në muajin mars, që shënon aktivizmin e grave, por trashëgimia e saj mbetet e gjallë.

Prandaj, lëvizja feministe e sotme në Kosovë është vazhdimësi e një historie të gjatë rezistence, vizioni dhe përkushtimi. Ajo mbështetet mbi sakrificat e grave që, në kohë represioni, guxuan të ëndërronin për një shoqëri më të barabartë dhe më të drejtë. Kjo trashëgimi është themeli mbi të cilin ndërtohet aktivizmi feminist i ditëve tona.

Pas luftës, puna e organizatave të grave vazhdoi me intensitet të shtuar, sepse nevojat për ekzistencën dhe punën e tyre ishin shtuar. I gjithë kontributi i dhënë i grave në të gjitha fushat pothuajse u harrua dhe institucionet nuk po merreshin

me traumën nëpër të cilën kishin kaluar ato, kurse për mirënjohje as që bëhej fjalë. Përveç organizatave vendore filluan punën një numër i madh organizatash ndërkombëtare, të cilat kontribuan në fuqizimin e grave duke ofruar, ndër të tjera, edhe mundësitë e rrjetëzimit me organizata globale.

Një nga këto organizata është edhe Women for Women International, e cila punën e filloi në vitin 1999, duke u angazhuar në fuqizimin social dhe ekonomik të grave të marginalizuara kryesisht në zonat rurale. Secili nga komponentët e programit të saj kishte rëndësi të veçantë, sepse ishin të kombinuar në mënyrë të tillë që gratë të aftësoheshin të bëheshin qytetare aktive dhe pjesë e një lëvizjeje që punon për barazi të të drejtave mes burrave dhe grave në Kosovë.

Falë punës dhe aktivizmit të shumë grave, Kosova si shtet i dalë pas luftës ka shënuar progres, por ende mbetet larg arritjes së barazisë gjinore. Avokimi dhe përpjekjet e grave aktiviste kanë bërë të mundur që barazia gjinore të përfshihet në shumicën e ligjeve, megjithatë zbatimi i tyre dhe krijimi i mundësive, veçanërisht në përfshirjen e grave në tregun e punës, lënë ende shumë për të dëshiruar.

Ka fusha ku çështja gjinore nuk merret aspak parasysh dhe ligjet nuk e përfshijnë, për shembull, fusha e mbrojtjes së ambientit. Duke pasur parasysh ndryshimet klimatike dhe varfërinë që e shkaktojnë ato, e cila më së shumti i prek gratë – do të ishte e domosdoshme që këta faktorë të integroheshin në hartimin e politikave.

Dhe sikur të mos mjaftonin pengesat strukturore brenda shoqërisë kosovare, edhe problemet në nivel global e godasin gjendjen e brishtë



të grave në Kosovë: kriza ekonomike, rritja e populizmit, gjuha e urrejtjes në internet dhe një frymë antigjinore në rritje.

Përkundër të gjitha këtyre sfidave, aktivistet e Kosovës të cilat në shumë raste janë pjesë e rrjeteve globale të aktivizmit, vazhdojnë punën e përditshme dhe angazho-

hen që hap pas hapi ta arrijnë synimin që gratë të jenë të faktorizuar dhe të kenë hapësira të kontribuojnë për një shoqëri me sa më shumë mundësi për zhvillimin e potencialit.

Autorja është Drejtore Ekzekutive e Kosova - Women 4 Women.

A mund të flasim ende për një “lëvizje” kundër gjinisë?



Valmira Rashiti

Në dekadat e fundit, gratë dhe komunitetet feministe në mbarë botën kanë përjetuar një valë të re sfidash nga forcat konservatore dhe populiste, të cilat nuk janë thjesht reagime të izoluar lokale, por pjesë e një strategjie globale për të rikthyer kontrollin mbi trupat e grave dhe personave queer. Nga Evropa Perëndimore e deri në Amerikë dhe Ballkan, narrativat e së djathtës nuk synojnë vetëm të imponojnë ide të ekonomisë së tregut të lirë apo forcën e shtetit, por të forcojnë hierarkitë patriarkale, nacionalizmin ekstrem dhe militarizimin e shoqërisë, duke përdorur frikën dhe pasigurinë sociale për të legjitimuar kontrollin mbi gratë, minoritetet dhe liritë individuale.

Përligjja graduale e luftës së lëvizjes feministe për drejtësi sociale e gjinore është një terren tjetër i cili është prekur dhe po ndikohet ndjeshëm, përfshirë edhe në kontekstin e Kosovës, e cila shpesh konsiderohet kinse qëndron në periferi të trendëve dhe politikave globale. Narracione të maskuara nën petkun e “mbrojtjes së vlerave tradicionale” janë kthyer në instrumente të fuqishme politike që synojnë pengimin e avancimit të të drejtave të grave, komunitetit LGBTQI+ dhe

drejtësisë gjinore në përgjithësi. Përgjatë viteve të kaluara, sidomos pas vitit 2020, këto përpjekje për t'i delegitimuar përpjekjet për barazi gjinore në Kosovë u kornizuan nga aktivistë/e si lëvizje kundër gjinisë. Filloi njëfarë mobilizimi për t'i identifikuar këto lëvizje, për të parë se si po e ndikojnë përditshmërinë e jetërave të grave dhe personave queer në Kosovë.

Por, çfarë janë në realitet lëvizjet kundër gjinisë?

Judith Butler, në librin e saj më të fundit të vitit 2025, *Who Is Afraid of Gender?*, argumenton se lëvizjet kundër-gjinore udhëhiqen nga një logjikë apo një mënyrë e renditjes së botës që përthith dhe riprodhon ankthet apo frikërat lidhur me pasigurinë sociale, zhvendosjen, humbjen e pushtetit patriarkal si në familje, ashtu edhe në shtet; humbjen e supremacisë së bardhë dhe “ruajtjen” e pastërtisë kombëtare. Gjatë procesit të riprodhimit të këtyre anktheve, burimi i tyre kyç eksternalizohet dhe armiku cilësohet të jetë: “gjinia”.

Butler shpjegon se ky kundërsulm ndaj gjinisë nuk është vetëm ideologjik, por edhe politik, duke synuar ta reduktojë kuptimin e gjinisë në aspektin e biologjisë së pandryshueshme të burrave dhe grave. Rendi patriarkal historikisht e ka përdorur biologjinë për shtypjen e grave, ndërsa duke e rikthyer këtë narrativë synon të rikthehet tek biologjia, si mënyrë për t'i rikthyer gratë në rolet gjinore brenda shtëpisë dhe punës së papaguar.

Edhe pse hulumtime të hollësishme për mënyrat e funksionimit, rrjetet e mobilizimit apo financimin e lëvizjes kundër-gjinore në Kosovë

ende mungojnë, përvojat e aktivisteve/ëve feministe/ë dhe ato të personave LGBTQI+ tregojnë se këto narrativa po përsëriten dhe forcohen përmes disa mekanizmave, të cilët janë kryesisht institucionale dhe kryekëput partiakë, politikë.

Narrativat të cilat i demonizojnë përpjekjet për drejtësi gjinore erdhën në shprehje në Kosovë, sidomos me diskursin parlamentar dhe publik, i cili u përdor kundër personave queer, për të shpërndarë keqinformim mbi çështje themelore të të drejtave të tyre për të krijuar familje, të cilat i kërkonin përmes Projekt-Kodit Civil. Më pas, po të njëjtët pri-jës politikë u angazhuan edhe kundër miratimit të Projekt-Ligjit për Shëndet Riprodhues, i cili në përmbytjen e tij parashihte Fertilizimin e Asistuar Mjekësor, si proces dhe e drejtë që do t'u takonte edhe grave beqare të Kosovës.

Në këtë kontekst duhet lexuar edhe mënyra se si politikat sociale artikulohen nga vetë shteti. Propozimet për shtesa financiare për lehonat shpesh paraqiten si politika emancipatore apo si mbështetje për gratë, por në mungesë të investimeve strukturore në çerdhe publike, kujdes institucional për fëmijët dhe politika të qëndrueshme të punësimit, ato rrezikojnë të funksionojnë më shumë si instrumente pronataliste sesa si politika reale të barazisë gjinore.

Retorika të këtyra nxitëse të pri-jësve të partive politike - të cilat, fundi i fundit, mbeten thellësisht patriarkale nga struktura, duke etek-tuar komunitetin LGBTQI+ si “kërcënim ndaj shëndetit publik”, ose duke e mohuar autonominë tru-

pore të grave, ka kontribuar viteve të fundit në krijimin e një atmosfere ku frika dhe paragjykimet e pabazuara mbizotërojnë mbi të drejtat njerëzore dhe të vërtetën. Kjo gjuhë dhe këto taktika janë të ngjashme me ato që shohim në vende të tjera - nga Polonia deri në SHBA, ku çështjet e trupit dhe identitetit seksual janë kthyer në fushë-beteja politike.

Këto zhvillime nuk duhet kuptuar si reagime spontane ndaj “krizave morale” – të shpikura nga pushteti politik, në pozitë e në opozitë, por si strategji politike të lidhura ngushtë me nacionalizmin, populizmin dhe ritradicionalizimin. Kur gjinia dhe seksualiteti përdoren si terrene për denigrim dhe kufizim të të drejtave, fushat të cilat ishin dashtë të jenë prioritare në diskursin politik, si: mirëqenia dhe drejtësia sociale, shëndetësia, strehimi dhe banimi social, automatikisht bien në rend të dytë. Kështu, pri-jësit politikë shfrytëzojnë pasigurinë sociale për t'i rikthyer pabarazitë strukturore dhe për të ruajtur rendin patriarkal si “normë” e veshur me “traditën” kombëtare, patriarkale apo shoqërore.

Në këtë situatë frike dhe paniku, aktivizmi dhe solidariteti feminist vështirësohen.

Aktivistët dhe aktivistet përballen jo vetëm me rezistencë ideologjike, por edhe me kërcënime konkrete karshi mirëqenies së tyre, sulme mbi reputacionin e tyre individual apo mbi qëllimet e përpjekjeve kolektive për barazi, e shpeshherë edhe me policim e disiplinim përmes forcës. Kështu tentohet të reduktohen përpjekjet dhe mundësitë për mobilizim dhe orga-

nizim të aktivisteve/ëve.

Situata ka arritur në atë pikë sa nuk mund të flitet më për një lëvizje kundër gjinisë si një lëvizje që është në proces të rikthimit të normave patriarkale, seksuale e gjinore. Këto lëvizje tashmë janë pushtet i stabilizuar në institucione politike e shtetërore edhe në Kosovë. Ato nuk janë më thjesht rezistencë ndaj barazisë, por projekte të fuqishme politike dhe ideologjike që përfshijnë jo vetëm Kosovën, por edhe kontekste të tjera në rajon dhe më gjerë.

Alternativa e vetme për t'u përballur me këtë valë tashmë të mirë-stabilizuar dhe institucionalizuar të lëvizjeve kundër gjinisë është solidariteti ndër-feminist dhe organizimi kolektiv, i cili përfshin organizimin e përbashkët me aktiviste/ë në fushat e të drejtave të punës, të refugjatëve, personave të zhvendosur, personave me aftësi të kufizuara dhe grupe të tjera shoqërore, përpjekjet e të cilëve/ave për drejtësi shpesh mbesin në marginë. Kjo nuk ndihmon vetëm për ta çliruar diskursin publik nga narrativat kundër-gjinore, por gjithashtu tregon se barazia e drejtësia gjinore është pjesë e një betejeje shumë më të gjerë për liri dhe drejtësi shoqërore. Aktivizmi i ndërthurur feminist mund t'i zhvendosë debatet nga ankthi dhe paniku moral i prodhuar e i mirëmbajtur nga pushteti tek nevojat reale sociale dhe ekonomike të komuniteteve.

Kështu mund të kuptohet që nga gjinia dhe seksualiteti nuk ka arsye për të pasur frikë.

Autorja është aktiviste feministe.

Organizatat e grave nuk janë alternativë, por themel i mbrojtjes nga dhuna



Adelina Berisha

Dhuna ndaj grave në Kosovë vazhdon të jetë një realitet i dhimbshëm dhe i përditshëm. Si një nga krimet më të përhapura në vend, ajo mbetet ndër çështjet më serioze të të drejtave të njeriut dhe të sundimit të ligjit. Ajo nuk është vetëm problem privat apo familjar; është problem shoqëror, institucional dhe strukturor që prek themelet e sigurisë dhe barazisë në vend.

Sipas të dhënave nga Policia e Kosovës, gjatë katër viteve të fundit janë regjistruar 10.220 raste të dhunës në familje, duke e bërë atë krimin e dytë më të raportuar në vend, pas vjedhjes me 16.287 raste. Por, statistikat e tregojnë vetëm një pjesë të realitetit. Shumë raste mbeten të paraportuara për shkak të frikës, varësisë ekonomike, pre-

sionit familjar apo mungesës së besimit në institucione. Kjo do të thotë se përmasat reale të dhunës janë edhe më të mëdha.

Pas çdo statistike është një grua që ka jetuar me frikën e pas çdo rasti të raportuar është një sistem që nuk ka arritur ta mbrojë me kohë. Kur dhuna fillon e kur familja hesht dhe komuniteti fajëson viktimën, organizatat e grave janë shpesh të vetmet hapësira ku një grua mund të kërkojë ndihmë pa u gjykuar.

Për vite me radhë, organizatat e grave kanë ndërtuar mekanizmat e parë dhe më të besueshëm të mbështetjes për gratë që përjetojnë dhunë. Përmes strehimoreve është ofruar siguri fizike, mbështetje emocionale dhe këshillim ligjor, duke u ndihmuar grave të kërkojnë drejtësi dhe të rindërtojnë jetën e tyre. Përmes mbështetjes psikologjike dhe sociale është kontribuar në rikthimin e vetëbesimit dhe dinjitetit të grave që kanë përjetuar trauma të thella.

Përtej reagimit emergjent, organizatat e grave kanë luajtur rol kyç edhe në ndryshimin e politikave publike. Ato e kanë ngritur zërin për përmirësimin e legjislacionit, për njohjen e dhunës me bazë gjinore si problem strukturor, për trajnim më të mirë të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve, si dhe për koordinim më efektiv ndër-institucional. Shumë nga përparimet që sot i konsiderojmë si standarde minimale janë rezultat i dekadave të punës së palodhur të aktivisteve feministe.

Megjithatë, edhe pse ky rol është i pazëvendësueshëm, ai shpesh mbetet i nënvlerësuar dhe i pam-bështetur sa duhet. Financimi i tyre shpesh është afatshkurtër, i pasigurt dhe i varur nga ciklet e donatorëve. Kjo krijon pasiguri jo vetëm për stafin, por edhe për gratë që mbështeten në këto shërbime për sigurinë e tyre.

Sot ky rol bëhet edhe më i rëndësishëm në një kohë kur diskursi antigjinor po përpiqet ta minojë konceptin e barazisë gjinore dhe ta delegjitimojë punën e organizatave feministe. Narrativat që e paraqesin barazinë gjinore si “ideologji”, apo si kërcënim ndaj familjes, janë përpjekje për ta kthyer pas orën e të drejtave të grave. Sulmet ndaj aktivisteve dhe organizatave të grave nuk janë vetëm sulme ndaj indi-

vidëve apo organizatave; ato janë sulme ndaj vetë idesë se gratë meritojnë të jetojnë pa dhunë, me dinjitet dhe me të drejta të barabarta.

Përballë një klime gjithnjë e më të pasigurt gjeopolitike dhe financiare, Rrjeti i Grave të Kosovës realizoi anketime me 103 organizata për të drejtat e grave. Gjetjet tregojnë një realitet shqetësues: 40% e organizatave raportojnë ulje të fondeve në dy vitet e fundit; 59% nuk kanë asnjë të ardhur të siguruar për vitin 2026. Mungesa e një linje të qëndrueshme buxhetore shtetërore dhe reduktimet e përitura nga donatorët kanë sjellë pushime nga puna, ulje të shërbimeve dhe rritje të pasigurisë për aktivistët. Megjithatë, 91% e tyre deklarojnë se do të vazhdojnë punën edhe pa mbështetje financiare. Kjo është dëshmi e përkushtimit të jashtëzakonshëm, por nuk duhet të bëhet normë që mbijetesa e shërbimeve jetike të varet nga sakrifica personale.

Solidariteti mes organizatave të grave dhe aktivisteve është jetik, por ai nuk mjafton pa mbështetje të gjerë shoqërore. Shoqëria duhet ta njohë se organizatat e grave nuk

janë thjesht një “zgjatim” i sistemit, por janë pjesë thelbësore e tij. Ato plotësojnë boshllëqe që shteti ende nuk ka arritur t’i mbulojë plotësisht dhe shpesh veprojnë më shpejt, më ndjeshëm dhe më afër komunitetit.

Mbështetja për organizatat që ofrojnë shërbime për gratë që kanë përjetuar dhunë duhet të jetë e qëndrueshme, institucionale dhe afatgjate. Financimi i bazuar vetëm në projekte nuk mjafton për të përballuar një problem kaq serioz dhe të përhapur.

Në fund, e vërteta është e qartë: organizatat e grave kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë vija e parë e mbrojtjes kundër dhunës. Ato nuk janë alternativë që mund të zëvendësohet lehtësisht; janë themel mbi të cilin është ndërtuar sistemi i mbrojtjes për shumë gra në Kosovë. Mbështetja e organizatave të grave nuk është vetëm akt solidariteti moral. Është investim për një shoqëri më të drejtë, më të sigurt dhe më të barabartë për të gjithë.

Autorja është Drejtore e Programit për Adresimin e Dhunës me Bazë Gjinore në Rrjetin e Grave të Kosovës.

Lindje, tmerr, dhunë

Eurisa Rukovci

Në Kosovë nuk ka fjalë për atë që u ndodh grave në dhomat e lindjes. As në ligj. As në ndonjë dokument strategjik, udhëzim ministror apo protokoll spitalor. Mund ta shfletosh Ligjin për Shëndetin Riprodhues, Ligjin për të Drejtat e Pacientëve si dhe Strategjinë Kombëtare kundër Dhunës ndaj Grave. Do ta gjesh “dinjitetin”. Do ta gjesh “pëlqimin e informuar”. Do ta gjesh “lirinë nga trajtimi mizor, çnjerëzor ose poshtërues”. Por nuk do të gjesh emër për atë që 95 për qind e grave, në një mostër prej 1229 vetash, apo lexuar ndryshe 1171 gra, na thanë se u kishte ndodhur kur shkuan të lindnin në një spital në Kosovë. 334 prej këtyre grave përshkruan në detaje përvojat e tyre.

Kamy thoshte se absurdi lind nga përballja mes nevojës njerëzore dhe heshtjes së paarsyeshme të botës. Po të kërkonte shembull, do ta gjente në sallat e lindjes në Kosovë.

Ja çfarë mbulon heshtja: gra të lëna vetëm për dhjetëra orë gjatë lindjes aktive, duke bërëtitur, pa ardhur askush. Pastrime të mitrës pa anestezi. Manovra Kristeller, një praktikë që OBSH-ja e konsideron të rrezikshme, e zbatuar në mënyrë rutinore dhe pa pyetur. Gra të cilave u thuhej, mes kontraksioneve, se “vetë e kanë lypë”. Një grua që kishte lindur foshnjën e vdekur e vetme – gjersa stafi flinte – dhe pasi qëndroi me të për tridhjetë minuta pa ardhur askush, e detyruan të nënshkruante një letër: nëse vdes ajo vetë, është faji i saj. Një tjetër që tani mban pelena gjithë jetën për shkak të dëmtimit të muskujve gjatë lindjes dhe rrëfen: “Jeta ime si grua ka mbaruar”.

334 gra i shkruan këto gjëra me fjalët e veta. I shkruan në gjuhën shqipe, me fjali të gjata, me e pa shenja të pikësimit, me shkronja të mëdha, mes orareve të ushqyerjes të foshnjave të tyre, e në pauza të punës. Askush s’ua kishte kërkuar. Anketa u dha një hapësirë teksti dhe ato e mbushën.

Pra, 1171 gra raportuan të paktën një formë keqtrajtimi. Keqtrajtimet

më të përhapura përfshinin neglizhimin ose minimizimin e dhimbjes së grave (871 gra) dhe abuzimin verbal ose mungesën e respektit (709 gra), pasuar nga lënia e grave të vetme për periudha të gjata gjatë lindjes (599 gra). Shkelje të tjera përfshinin ekspozimin pa privatësi (589 gra), kushtet johigjienike (353 gra), ndërhyrjet e panevojshme mjekësore (334 gra), procedurat e kryera pa pëlqimin e informuar (211 gra) dhe mohimin e kujdesit për shkak të paragjykit (161 gra)

E, 848 gra që kishin përjetuar forma të ndryshme të dhunës nuk e kishin raportuar kurrë, sepse besonin se asgjë s’do të ndryshonte. Statistikisht, kishin të drejtë.

Kanali zyrtar i ankesave në Kosovë për shkelje në kujdesin shëndetësor mori 164 ankesa në vitin 2024. 119 prej tyre nuk morën asnjë përgjigje. Masa totale disiplinore për vitin 2024: një gjobë, një vërejtje verbale. 52 ankesa ishin konkretisht për sjellje joprofesionale. Zero u kategorizuan si të lidhura me lindjen. Sepse kategoria nuk ekziston.

Ky është truku. Mungesa e emrit bën punën e një fshehjeje të tërë pa pasur nevojë të komplotojë askush. Pa emër s’ka kuti ankesash, s’ka rubrikë në formularët e inspektimit, s’ka zë në buxhet, s’ka module trajnimit për staf shëndetësor, s’ka bazë të të dhënash, s’ka objektiva politikash. Dhuna bëhet strukturalisht e padukshme e kështu edhe fshihet. Populli Pirahâ në Amazonë nuk ka fjalë për numra specifikë. Ata i shohin pesë peshq, por s’thone “pesë”. Kosova i sheh gratë duke u brutalizuar gjatë lindjes. Thjesht s’mund të thotë “dhunë obstetrike”.

Dhe ja ku situata bëhet përnjëmend absurde: ligjet tashmë e ndalojnë gjithçka që ndodh në spitalet tona. Neni 26 i Kushtetutës mbron të drejtën për të marrë vendime për trupin tënd dhe për të refuzuar trajtim mjekësor. Neni 27 ndalon trajtimin poshtërues. Ligji për të Drejtat e Pacientëve kërkon pëlqimin e informuar për çdo procedurë invazive. Të drejtat ekzistojnë. Zbatimi jo. Gratë, megjithatë,

vazhdimisht dëmtohen nga hendeku mes asaj që u garantohet me ligj e asaj që zbatohet.

Ajo që përshkruajnë këto gra është dhunë me bazë gjinore, e ushtruar brenda institucioneve, ndaj njerëzve në gjendjen më të cenueshme fizikisht në të cilën hyn trupi i njeriut, nga profesionistë që mbajnë pushtet absolut mbi to në atë moment. Konventa e Stambollit, të cilën Kosova e futi drejtpërdrejt në Kushtetutë në vitin 2020, e përkufizon dhunën ndaj grave si çdo akt dhune me bazë gjinore që rezulton në dëm fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik. Nuk ka fusnotë në fund të faqes që thotë “përveç në spitale”.

Megjithatë, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022–2026) mbulon dhunën nga partneri intim, ngacmimin seksual, dhunën në komunitet. Tash për tash nuk thotë asgjë për atë që ndodh në dhomat e lindjes. Por, kjo nuk do të thotë që në të ardhmen nuk do të përfshihet. Për herë të parë, dhuna obstetrike u soll nga ne si dimension i domosdoshëm në punëtoritë e muajit të fundit të Agjencisë për Barazi Gjinore gjatë hartimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, me ide të qartë që duhet të njihet ligjërisht dhe pa ekuivoke si dhunë me bazë gjinore.

Gjithsesi, pas publikimit të raportit nga “Grazeta”, diçka po lëviz. Dy vjet më parë, për këtë temë as flitej në Kosovë. Sot po flitet, ka të dhëna, si dhe ka institucione që kanë filluar të kenë vesh për tmerrin e grave gjatë lindjes.

Për çdo grua që po e lexon këtë dhe e njohu përvojën e vet diku mes këtyre numrave: bëj ankesë! Tani! Përdor atë që ekziston! Ndarjen për të Drejtat e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor, zyrat e të drejtave të pacientëve, inspektoratin shëndetësor. Po, mekanizmat janë të pamjaftueshëm. Po, shumica e ankesave humbin në një sirtar. Bëje gjithsesi! Një sistem që shpërfill dhjetë ankesa mund të shtiret se s’ka problem. Një sistem që rri mbi dhjetë mijë ankesa s’mund të shtiret. Çdo



ankesë e regjistruar është provë. Çdo ankesë pa përgjigje është gjithashtu provë — thjesht e një lloji tjetër. Bëje shtetin ta ndërtojë gjurmën dokumentare që ka refuzuar ta ndërtojë vetë.

Një gjë e fundit. Ky studim, i pari i këtij lloji dhe i kësaj shkalle në Kosovë, nuk u krye nga Ministria, as nga Inspektorati Shëndetësor, as nga ndonjë institucion, detyra e të cilit është të monitorojë si trajtohen gratë. U krye nga një psikologe me një formular në Google dhe me një buxhet për rrjete sociale. 1229 gra u përgjigjën, sepse dikush më në fund i pyeti. Detyrimi i shtetit për të

dokumentuar dhunën ndaj grave në spitalet e veta u përmbush tash për tash nga vetë gratë.

Për dekada, gratë e Kosovës kanë jetuar brenda një lloji heshtjeje – heshtje ku përvoja jote është e vërtetë, por bota s’ka kategori për të, kështu që mësohesh mos ta përmendësh. Mësohesh ta normalizosh atë. Mësohesh t’ia thuash motrës, shoqes, vajzës... dhe kaq.

Por, s’ka pse të jetë kështu! Duhet të jetë më mirë! Gratë kosovare meritojnë kujdes obstetrik të dinjitetshëm!

Autorja është gazetare.

Mes vetëbesimit dhe strukturës: Pse gratë mungojnë në teknologji



Jeta Zagragja

Mes strukturës dhe vetëbesimit: rruga e grave në teknologji

Sa herë flasim për gratë në teknologji, pyetja lind natyrshëm. Por, para bindjeve personale le t'i referohemi realitetit.

Sipas Forumit Botëror Ekonomik, gratë përbëjnë rreth 29% të fuqisë punëtore në STEM dhe më pak se 20% në role udhëheqëse. Me ritmin aktual, barazia ekonomike gjinore është më shumë se një shekull larg.

Studimet e McKinsey & Company tregojnë se gratë janë të nënpërfaqësuar në çdo nivel, veçanërisht në menaxhim të lartë. Sipas Komisionit Evropian, në BE ato përbëjnë më pak se një të tretën e menaxherëve teknikë dhe edhe më pak CEO. Ndërsa globalisht, vetëm rreth 2% e venture capital shkon për kompani të themeluara vetëm nga gra.

Këto nuk janë perceptime, por fakte. Dhe nuk është çështje ideologjie, është çështje funksionimi. Kur gjysma e talentit nuk arrin proporcionalisht në vendimmarrje dhe kapital, sistemi nuk po punon si duhet.

Barrierat nga jashtë: kur ambienti vendos kufijtë

Në teknologji, barrierat e jashtme nuk janë gjithmonë të zhurmshe, janë të pranishme. I ndjen në detaje të vogla, në mënyrat si bëhen pyetjet, në heshtjet që zgjasin pak më shumë seç duhet.

“Jeta, si është të jesh femër në teknologji?” - ishte pyetja që mora në një panel për investime në teknologji.

Tre kolegë meshkuj u pyetën për politika shtetërore, strategji sektoriale dhe ndërtim ekosistemi, për vizion dhe strukturë, unë për impaktin e grave dhe arritjet e mia “pavarësisht moshës”.

E ndjeva dallimin, por refuzova ta zhvendosja fokusin nga investimet në sektorin e teknologjisë në Kosovë drejt përfaqësimit.

Për mua, teknologjia është hapësirë idesh, jo etiketime. Dhe këto dallime të vogla tregojnë sa rrugë kemi ende për të bërë.

Ekziston paragjykimi i pavetëdijshëm në rekrutim dhe promovim: mungesa e përfaqësimit. Kur je e pranishme në një sallë bordi dhe e kupton që je e vetmja grua. Në perspektivën e të tjerëve është çështje “përrjashtimi”, dhe jo një normë. Pra, nuk e përfaqëson vetëm veten.

Kur një burrë udhëheq një ekip teknik, kjo shihet si normale. Kur një grua udhëheq, shpesh analizohet mënyra se si ajo e bën këtë. A është shumë e fortë? A është shumë e butë? A është “e pëlqyeshme”? Lider shipi mashkullor është pritshmëri. Lider shipi femëror shpesh trajtohet si fenomen.

Barrierat nga brenda: kur zërat e jashtëm bëhen zë i brendshëm

Kur barrierat e jashtme i përjeton për vite me radhë, fillojnë të lënë gjurmë brenda teje. Nuk janë më vetëm komente apo statistika, bëhen dyshime të vogla të cilat ngadalë zënë vend në mendje.

Studimi i njohur “Heidi/Howard” e tregon qartë këtë realitet: i njëjti profil profesional perceptohet ndryshe vetëm për shkak të emrit. Howard shihet si lider i fortë, i vendosur. Heidi, me të njëjtën CV, shihet si ambicioze në mënyrë jo të pëlqyeshme. Si dikush që “do shumë”!

Kur një mesazh i tillë përsëritet vazhdimisht, në intervista, në takime, në reagime të vogla, fillon të ndodhë diçka më e thellë: internalizimi. Gratë shpesh i nënvlerësojnë aftësitë e veta, edhe kur performanca e tyre është e barabartë ose

superiore.

Kam parë gra brilante që e nënvlerësojnë performancën e tyre, edhe kur rezultatet flasin qartë. Kam dëgjuar fjali si: “Ndoshta nuk jam ende gati”. Ndërkohë që janë më shumë se gati.

Pyetja: “A e mbajnë veten mbrapa?” shpesh buron pikërisht nga ky fenomen. Por, duhet të pyesim: Kush e krijoi ambientin që e prodhon këtë vetëkufizim?

Ndryshimet mes gjeneratave


Është e vërtetë që gjeneratat e reja po rriten me më shumë hapësirë dhe më shumë guxim. Vajzat sot inkurajohen të hyjnë në STEM, të provojnë, të eksperimentojnë.

Ka më shumë modele, më shumë zëra që flasin për barazi, më shumë dritë mbi këtë temë se kurrë më parë. Sepse ndryshimi në zyrë nuk mjafton nëse nuk ndodh edhe në shtëpi. Nëse barra e kujdesit për fëmijët dhe punët e përditshme mbetet kryesisht mbi një palë, atëherë pabarazia thjesht zhvendoset nga një hapësirë në tjetrën. Ndarja reale e përgjegjësiive është një nga faktorët më të heshtur, por më vendimtar, në avancimin profesional të grave në teknologji.

Çfarë mund të bëjmë konkretisht në sektorin e teknologjisë?

Nëse e trajtojmë këtë si çështje ekonomike dhe jo ideologjike, zgjidhjet bëhen më të qarta. Fleksibilitet real në modele pune, që i përshtaten jetës dhe jo vetëm orarit të zyrës. Matje performace mbi rezultate dhe ndikim, jo mbi prezencë fizike. Transparençë në paga dhe në kriteret e promovimit, që rruga të jetë e qartë për të gjithë. Mentorim për gratë që kalojnë drejt roleve udhëheqëse, që të mos ecin vetëm. Politika që e bëjnë rikthimin pas pushimit të lehonisë normal dhe jo penalizues për karrierën.

Teknologjia është një nga sektorët me potencialin më të madh për mobilitet social dhe ekonomik. Për



shumë gra, përfshirja në këtë industri është privilegj dhe mundësi reale fuqizimi. Por, privilegji individual nuk e zëvendëson sistemin.

Përfundimi

Pra, a është problemi te gratë apo te sistemi?

Kur i sheh të dhënat, bëhet e qartë që ambienti krijon struktura që prodhojnë pabarazi. Me kalimin e kohës, individët mësohen t'u përshatën atyre strukturave, ndonjëherë duke e kufizuar veten pa e kuptuar.

Rasti i panelit që përmenda më herët është një shembull i thjeshtë, por domethënës. Pra, unë u pyeta për gjininë dhe moshën. Askush nuk kishte qëllim të keq. Mirëpo, papariprja e njëanshme apo paragjykimi i pavetëdijshëm formësojnë pritshmëritë. Dhe pritshmëritë formësojnë mundësitë!

Nëse duam më shumë gra në teknologji, më shumë themeluese startup-esh, më shumë CEO dhe vendimmarrje më të balancuar, atëherë duhet t'i ndryshojmë kushtet në të cilat ato operojnë. Kjo nuk është çështje korrektësie politike. Është çështje funksionimi, norme.

Si udhëheqës biznesesh, përgjegjësia është e jona të krijojmë ambiente pune që nuk e vendosin një nënë përballë dilemës: karrierë apo familje. Duhet të ndërtojmë struktura që e akomodojnë një grua që dëshiron të mbetet e përfshirë, të kontribuojë dhe të avancojë, pa u ndier e detyruar të shkëputet.

Sepse inovacioni kërkon diversitet. Dhe një sektor teknologjie që përfaqëson vetëm një pjesë të talentit nuk po operon me kapacitetin e tij të plotë.

Autorja është themeluese dhe kryeshefe ekzekutive e AnchorzUp.

Turizmi po rritet, por gratë po mbesin jashtë loje



Lavdi Zymberi

Kosova po përjeton një rritje të dukshme të turizmit. Bulevardi Nënë Tereza mbushet me vizitorë, sidomos gjatë verës; Prizreni gumëzhin gjatë verës; bujtinat në parqet kombëtare punojnë me kapacitete të plota dhe turizmi po promovohet si një nga sektorët më premtues të ekonomisë. Male “të virgjëra”, mikpritje tradicionale e paparë, histori rezistence dhe një shtet i ri që ka rimëkëmbur veten shpejt pas luftës dhe “ek-sporton” burime njerëzore, e sidomos të rinj e të reja që shkëlqejnë në fushën e teknologjisë informative - kjo është narrativa që po i paraqitet botës.

Por, pas këtij optimizmi në dukje fshihet një pyetje e pakëndshme, mirëpo thelbësore: kush po përfiton realisht nga turizmi në Kosovë?

Përgjigjja është e thjeshtë dhe shqetësuese: gratë jo. Për gratë në Kosovë, turizmi ofron mundësi, por

njëkohësisht nxjerr në pah disa nga pabarazitë më të qëndrueshme të shoqërisë sonë.

Gratë janë shtylla e padukshme e turizmit në Kosovë. Ato gatuajnë, pastrojnë, presin vizitorë, mirëmbajnë bujtina dhe mbajnë gjallë turizmin lokal, veçanërisht në zonat rurale. Megjithatë, rrallë shihen si pronare, menaxhere apo profesioniste të barabarta. Sipas dokumenteve strategjike të turizmit, vetëm rreth 5 për qind e pozitave menaxheriale mbahen nga gra, ndërsa puna e tyre shpesh mbetet e padukshme, e paregjistruar dhe e nënvlerësuar. Ky hendek nuk është rastësor. Ai pasqyron barriera strukturore të rrënjësura thellë, me të cilat gratë përballen në të gjithë tregun e punës në Kosovë, përfshirë qasjen e kufizuar në pronë, financa, rrjete profesionale dhe hapësira vendimmarrëse.

Në zonat rurale, shumë gra punojnë në bujtina familjare pa qenë të regjistruara si pronare biznesesh. Ky informalitet sjell të ardhura afatshkurtra, por nuk ofron siguri: pa kontrata, pa pensione dhe pa mbrojtje sociale. Turizmi, në vend që të jetë rrugë drejt pavarësisë ekonomike, rrezikon të kthehet në një vazhdim të punës së papaguar shtëpiake, vetëm se e zhvendosur në treg.

Pabarazia bëhet edhe më e dukshme në udhërrëfimin turistik, një

profesion që mbetet kryesisht mashkullor. Gratë që hyjnë në këtë fushë, sidomos në turizmin malor / aventurier, por edhe në atë kulturor, përballen me paragjykime, skepticizëm dhe mungesë mbrojtjeje ligjore. Megjithatë, një numër i vogël, por në rritje, grash të certifikuara po i thyejnë këto barrierat dhe po sfidojnë idetë e rrënjësura mbi atë se kush udhëheq, kush rrëfen dhe kush i “përket” hapësirës publike dhe natyrës.

Por, edhe këto gra veprojnë në një treg të parregulluar.

Këtu hyn në skenë GuideKS – Asociacioni i Guidave Turistike të Kosovës, i cili përfaqëson guida vendore të certifikuara dhe avokon për profesionalizëm dhe standarde etike. Megjithatë, në mungesë të një kuadri ligjor funksional, edhe GuideKS mbetet me duar të lidhura. Sot, guida të huaja veprojnë lirshëm në Kosovë, pa certifikim lokal, pa licencim dhe pa mbikëqyrje. Kjo i dëmton guidat vendore dhe veçanërisht gratë, të cilat janë tashmë të nënpërfaqësuar dhe më pak të lidhura me rrjete ndërkombëtare.

Përtej aspektit ekonomik, shtrohet një çështje më e thellë: kush e tregon historinë e Kosovës? Kur guidat e huaja dominojnë tregun, humbet sovraniteti narrativ dhe zërat e grave shtyen edhe më tej në prapavijë. GuideKS ka bërë thirrje të vazh-

dueshme për reforma ligjore, por përparimi ka qenë i ngadalshëm. Turizmi rritet, por rregullimi institucional mbetet prapa.

Problemi thellohet nga mungesa e rregullimit institucional. Kosova ende nuk ka një ligj të zbatueshëm për udhërrëfimin turistik që do të detyronte certifikim, licencim dhe mbikëqyrje për të gjithë udhërrëfyesit/et. Ndërkohë, Strategjia e Turizmit 2024–2030, ndonëse ambicioze në promovim, dështon t'i adresojë boshllëqet kryesore: nuk parasheh krijimin e një agjencie kombëtare të turizmit dhe as një zyrë turistike funksionale në Prishtinë.

Është paradoksale që kryeqyteti, si pika kryesore e hyrjes për turistët, nuk ofron as një hapësirë bazike institucionale ku vizitorët të informohen dhe profesionistët vendorë të koordinohen. Pa institucione turizmi mbetet i paorganizuar, ndërsa gratë përballen me një shtet që nuk garanton kushte të barabarta për zhvillim.

Në këtë kontekst, krijimi i Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit përbën një moment të rëndësishëm. Për herë të parë, turizmi po trajtohet si aspekt i rëndësishëm përtej të qenit një departament në një ministri me pak burime njerëzore. Kjo Ministri do të duhej të punojë për të: licencuar udhërrëfyesit/et turistike, duke përfshirë standarde të qarta

për certifikim, licencim dhe mbikëqyrje; ndaluar funksionimin e guidave të huaja në Kosovë, në pajtim me praktikat e vendeve tjera – madje edhe ato të rajonit; promovuar bizneset e vogla të udhëhequra nga gratë, përmes skemave të mikro-kreditimit, mentorimit dhe qasjes në financa; integruar barazinë gjinore në strategjinë kombëtare të turizmit, duke ndarë buxhet për trajnime, certifikime dhe infrastrukturë që nxit pjesëmarrjen aktive të grave në sektor; dhe duke zhvilluar një platformë kombëtare informimi për turistët që përfshin histori autoktone të prezantuar nga profesionistë vendorë, veçanërisht gra, që ruan sovranitetin narrativ të Kosovës.

Turizmi ka potencial të vërtetë për fuqizimin ekonomik të grave. Por, pa formalizim, pa rregulla dhe pa vullnet politik, ky potencial mbetet vetëm retorikë.

Në fund, turizmi nuk është vetëm ekonomi. Është rrëfim dhe identitet. Nëse gratë mbeten të padukshme dhe të pambrojtura, atëherë po e tregojmë vetëm gjysmën e historisë sonë. Dhe një industri që flet për Kosovën, por jo për dhe nga gratë, është një industri e ndërtuar mbi përjashtim.

Autorja është udhërrëfyesë turistike e certifikuar për Kosovë.

Nga heshtja te ndryshimi strukturor: Rikthimi i hapësirës feministe në drejtësinë tranzicionale



Venesa Sulimani

Në Kosovë për luftën flasin me kre-nari dhe pikëllim, por rrallë me sin-geritet për atë që ndodhi brenda shtëpive tona. Dhuna seksuale gjatë konfliktit shpesh mbështillet me heshtje dhe turp. Unë nuk u linda nga lufta: u linda në të. Jam e prekur nga dhuna seksuale gjatë konfliktit sepse, si fëmijë, jam dëshmitare e saj. Ai moment nuk përfundoi kur u larguan ushtarët. Na ndoqi në kohë paqeje - në klasa shkollash, tubime familjare dhe çdo hapësirë ku pritjet heshtja dhe e vërteta ishte shumë e rezikshme për t'u thënë. Në një shoqëri ku nderi shpesh vlerësohet mbi shërimin, thyerja e asaj heshtjeje nuk është vetëm personale. Është thelbësore për drejtësi dhe rimëkëmbje.

Heshtja për dhunën seksuale nuk është e rastësishme; ajo përforcohet nga normat dhe pritjet shoqërore që i japin përparësi reputacionit mbi shërimin. Duke u rritur në hijen e traumës së nënës sime, mësova që herët se këto përvoja nuk janë vetëm plagë personale, por edhe forca që formojnë familjet dhe komunitetet ndër breza. Trauma trashëgohet, jo thjesht durohet, megjithatë diskutimet rreth saj shpesh shmangen. Pranimi i këtyre realiteteve është një hap i nevojshëm drejt shërimit dhe drejtësisë kuptimplote.

Ishte kjo heshtje që më shtyu të merresha me avokim. Ia kam kushtuar punën time transformimit të padukshmërisë në zë dhe veprim. Përmes Synergy for Justice (Sinergji për Drejtësi), kam kontribuar me ekspertizë të udhëhequr nga të mbijetuarit/at në një webinar të lidhur me konsultimet e Strategjisë së Viktimave të Gjykatës Ndërkombëtare Penale 2025, duke avokuar për korniza drejtësie tranzicionale të informuara nga trauma dhe për njohjen e fëmijëve të prekur nga dhuna seksuale gjatë konfliktit brenda mekanizmave të mbështetjes dhe dëmshpërblimit.

Gjithashtu kam përfaqësuar të mbijetuarit/at në konferenca ndërkombëtare, duke përfshirë PSVI dhe Grupin Këshillues të të Mbijetuarve, duke siguruar që programet të mbeten të vetëdijshme për traumën, gjithëpërfshirëse dhe të përqendruara te të mbijetuarit/at.

Këto përvoja më kanë treguar se hapësirat feministe janë më të forta kur udhëhiqen nga të mbijetuarit/at dhe informohen nga trauma - të bazuara jo në simbolikë, por në realitetet e jetuara. Ato ofrojnë mbështetje, udhëzime dhe fuqizim, duke iu mundësuar të mbijetuarve t'i formësojnë proceset e drejtësisë, politikat publike dhe nismat në komunitet. Kur këto parime i udhëheqin ato, shërimi thellohet dhe progresi bëhet i qëndrueshëm.

Drejtësia tranzicionale e informuar nga trauma nuk ka të bëjë vetëm me adresimin e së kaluarës; ka të bëjë me ndërtimin e sistemeve të tashme dhe të ardhshme në të cilat të mbijetuarit/at mund të marrin plotësisht pjesë në shoqëri. Fëmijët dhe familjet e prekura nga dhuna seksuale gjatë konfliktit mbajnë barrë afatgjate emocionale, sociale dhe psikologjike. Programet që dështojnë t'i integrojnë perspektivat e të mbijetuarve humbasin njohuri kritike që mund të forcojnë kujdesin, mbështetjen dhe riintegrimin. Kur zërat e të mbijetuarve udhëheqin vendimmarrjen, nismat kalojnë nga reaguese në parandaluese, nga performuese në kuptimplote.

Në Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës kam punuar për të vënë në pah ndikimet afatgjata dhe ndërbrezore të dhunës seksuale gjatë kohës së luftës. Përmes përkujtimit të 25 vjetorit të tyre, unë e tregova publikisht historinë time për herë të parë, duke e transformuar dhimbjen private në ndërgjegjësim kolektiv. Organizata ka mbështetur bashkëpunimin me partnerët lokalë për të avancuar ofrimin e shërbimeve të ndërgjegjshme për traumën dhe për të forcuar riintegrimin në komunitet për të mbijetuarit/at dhe familjet e tyre. Në nivel ndërkombëtar, përmes Stand Speak Rise Up! (Qëndro Fol Çohu!) dhe The Brave Movement (Lëvizja e guximshme), kam avokuar për liderшипin e të mbijetuarve, njohjen etike dhe përfshirjen në diskutimet e politikave globale. Këto përvoja përfor-

cojnë një të vërtetë të thjeshtë, por të fuqishme: përvoja e jetuar është ekspertizë, jo turp.

Angazhimi i të rinjve është thelbësor për këtë punë. Fuqizimi i brezit të ardhshëm do të thotë pajisja e të rinjve me mjetet për të marrë pjesë në përpjekjet për shërim, avokim dhe ndërtim të komunitetit. Hapësirat feministe lulëzojnë kur të rinjtë nuk janë vëzhgues pasivë, por kontribuues aktivë - duke mësuar nga të mbijetuarit/at ndërsa i formësojnë praktikat e ardhshme.


Krijimi dhe mbështetja e këtyre hapësirave kërkon përkushtim, dhembshuri dhe dizajn të qëllimshëm. Veprimi feminist duhet të shkojë përtej ndërgjegjësimit drejt strukturave të qëndrueshme që mbështesin llogaridhënien, ushqejnë shërimin dhe vendosin në qendër ekspertizën e jetuar. Programet, kërkimet dhe ndërhyrjet duhet të zhvillohen me të mbijetuarat, jo vetëm për to. Grupet këshillimore, konsultimet dhe kornizat e politikave duhet të udhëhiqen nga ata/o që preken më drejtpërdrejt.

Sfidat janë reale. Pritjet sociale, stigma dhe trauma mund ta bëjnë pjesëmarrjen të vështirë. Megjithatë, rezultatet për të mbijetuarit/at, familjet dhe komunitetet janë të thella.

Hapësirat feministe të informuara nga trauma kultivojnë sigurinë, agjencinë dhe mundësinë. Ato sigurojnë që përvoja si e imja - dhe të tjera të panumërta - të njihen, të vlerësohen dhe të transformohen në veprime konstruktive.

Për Kosovën dhe globalisht, kjo punë është urgjente. Zërat e të mbijetuarve duhet të përfshihen në çdo nivel të drejtësisë, politikave dhe ofrimit të shërbimeve. Duhet të garantohej njohja etike dhe mbështetja e vazhdueshme për ata/o që kontribuojnë me ekspertizën e tyre. Programet duhet të adresojnë traumën ndërbrezore, duke zgjeruar hapësirën për fuqizim dhe lidhësi.

Kjo kërkon veprim konkret. Kornizat e dëmshpërblimeve dhe mbështetjes duhet t'i njohin zyrtarisht fëmijët e të mbijetuarve si bartës të të drejtave brenda proceseve të drejtësisë tranzicionale. Shumë shpesh, dëmi ndërbrezor pranohet retorikisht, por përjashtohet strukturalisht. Përfshirja formale do të siguronte qasje në shërbime psikosociale, mbështetje arsimore dhe masa afatgjata të riin-



tegrimit, të përshtatura për familjet e prekura nga dhuna seksuale gjatë konfliktit. Pa masa të tilla, drejtësia tranzicionale rrezikon ta adresojë dëmin pjesërisht në vend që ta adresojë atë në mënyrë sistematike. Përveç kësaj, akterët e drejtësisë duhet të marrin trajnim të detyrueshëm të informuar mbi traumën dhe të mbijetuarit/at që kontribuojnë me ekspertizë këshillimore duhet të mbrohen përmes mbrojtjeve etike të kompen-simit dhe standardeve të qarta të pjesëmarrjes.

Hapësirat feministe nuk janë thjesht mbështetëse; ato janë transformuese. Ato formojnë komunitete që dëgjojnë, përgjigjen dhe bëhen më të forta.

E shkruaj këtë si dikush e formuar nga përvoja personale dhe avokimi global - dikush që ka qenë dëshmitare e heshtjes, stigmës dhe rezistencës, dhe që ia ka përkushtuar jetën e saj lidhjes së përvojës së jetuar dhe re-

formës sistemike. Hapësirat feministe nuk janë ceremoniale. Ato janë vende fuqizimi, llogaridhënieje dhe ndryshimesh strukturore. Ato janë vendet ku të mbijetuarat rimarrin fuqitë e tyre, ku politikat pasqyrojnë realitetet e jetuara dhe ku komunitetet përballen me trashëgiminë e dhunës me guxim dhe dinjitet.

Ndërsa shënojmë Ditën Ndërkombëtare të Gruas, pyetja nuk është nëse hapësirat feministe janë të nevojshme, por nëse jemi të gatshëm t'i lejojmë ato të jenë të guximshme, gjithëpërfshirëse dhe të udhëhequra nga të mbijetuarat. Hapësirat feministe duhet të jenë reale, zhvilluese dhe transformuese. Derisa heshtja të përballet me njohje, mirëkuptim dhe ndryshim strukturor, drejtësia mbetet e paplotë.

Autorja është e mbijetuar dhe aktiviste për traumën ndërbrezore.

Gratë si aksesori politik i burrave që garojnë



Rreze Abdullahu

Zgjedhjet sapo kishin përfunduar. Studioli televizivë ishin mbushur me analiza për rezultatet, koalicionet, përqindjet dhe kalkulimet e pushtetit lokal. Në këtë atmosferë mora një ftesë për debat. Tema nuk ishte programi i kandidatëve burra për kryetar komune. Nuk ishte përgatitja e tyre profesionale. Nuk ishte vizioni i tyre për qytetet. Tema ishte: pamja e grave të tyre.

Diskutimi parashihej të përfshinte krahasime: kush dukej më elegante, kush ishte më prezente në fushatë, kush “e përfaqësonte më mirë” burrin e saj.

Në atë moment u bë e qartë: edhe kur gratë nuk janë kandidatë, ato mbeten pjesë e analizës publike. Jo si subjekte politike, por si zgjatim es-

tetik i burrave që garojnë.

Vendosa të mos shkoja në atë emision. Jo sepse temat mediatike duhen shmangur, por sepse mënyra si ishte ndërtuar diskutimi e zhvendoste fokusin nga politika tek estetika. Mungesa ime dhe e bashkëaktivisteve tjera intelektuale nuk e ndaloj zhvillimin e debatit. Këto diskutime vazhdojnë edhe kur i refuzojmë, por ndonjëherë refuzimi është forma e vetme e qëndrimit, sepse kjo nuk është thjesht çështje shijeje mediatike. Është reflektim i një strukture më të thellë.

Shoqëria jonë e ka ndërtuar figurën e “gruas së politikaniit” si figurë ceremoniale: e kuruar, e buzëqeshur, mbështetëse, por jo protagoniste. Prezente, por jo me zë të fortë. E dukshme në pamje, e padukshme në pushtet.

Ajo duhet të jetë elegante, por jo shumë ambicioze. Politike, por jo shumë e zëshme. E angazhuar, por jo me e spikatur se burri. Me pak fjalë: një aksesori publik.

Në diskutimin që po përgatitej për-mendëj edhe bashkëshortja e Zohran Mamdanit, si shembull i një gruaje që dukej bukur, por që nuk diskutohej për atë se kishte qenë aktive në fushatë. Kjo ishte e parëndësishme në natyrën e atij panel diskutimi, derisa

ajo që e bën rastin e tyre interesant nuk është pamja e saj. Është mënyra si ai e ka afirmuar publikisht identitetin e saj profesional. Ai ka thënë: “Rama nuk është aksesori i jetës sime politike, por një zë më vete në kulturë dhe art”.

Kjo fjali është më shumë se kompliment bashkëshortor. Është deklaratë politike. Sepse e zhvendos gruan nga sfondi ceremonial në qendër të identitetit të saj profesional. Ajo nuk prezantohet si dekor i suksesit të tij, por si artiste me arritje të pavarura.

Ky është një aspekt tjetër i pabarazisë që rrallë diskutohet: sa i mbështesin burrat politikanë profesionet e grave të tyre? Sa e afirmojnë publikisht autonominë e tyre?

Sepse shpesh politika kërkon që grua-ta të përshtatet me kalendarin, imazhin dhe narrativën e burrit. Rralëherë e shohim të kundërtën. Edhe në demokraci të konsoliduara, dinamika mbetet e ndërlikuar.

Barack Obama dhe Michelle Obama shpesh përmenden si model partneriteti. Por, Michelle Obama kishte një karrierë të suksesshme juridike dhe ekzekutive shumë përpara Shtëpisë së Bardhë. Ajo nuk u formësua nga presidenca e tij; ajo hyri aty me iden-

titet të konsoliduar profesional. Megjithatë, për vite me radhë, diskursi publik u fokusua në fustanet e saj, pamjen fizike apo rolin si nënë.

Rasti i Bill Clinton dhe Hillary Clinton është edhe më domethënës. Bill Clinton ka pranuar publikisht se ajo ishte më e zgjuar se ai. Hillary kishte karrierë të fuqishme juridike dhe politike shumë përpara presidencës së tij. Por, kur ajo hyri në garën presidenciale, media shpesh e rikornizoi si “gruaja e ish-presidentit”. Edhe kur mbështetja ekziston, perceptimi publik vazhdon ta reduktojë gruan në raport me burrin.

Në anën tjetër, jetojmë në një vend me “Zotërinë e Parë”, bashkëshortin e një presidenteje. Ai është përkrahës publik i punës së saj, por vazhdon angazhimet e veta profesionale pa u shndërruar në figurë ceremoniale. Askush nuk e analizon kostumin e tij. Askush nuk e diskuton pamjen e tij si reflektim të presidencës. Askush nuk e krahason me bashkëshortë të tjerë politikë. Ne nuk flasin pëthuajse kurrë për burrat e grave në politikë. Sepse burrat nuk perceptohen si zgjatim simbolik i pushtetit të gruas. Identiteti i tyre profesional mbetet i paprekur nga marte-sa. Ata mbeten individë.

Ndërsa për gratë gjithmonë ndodh e kundërta. Kjo është pabarazia e heshtur. Jo vetëm që gratë gjykohen për pamjen. Por, identiteti i tyre profesional kushëzohet nga pozicioni i burrit. Ato shihen si pjesë e imazhit të tij politik, jo si subjekte autonome.

Kur media zgjedh të analizojë pamjen e grave të kandidatëve në vend të përgatitjes së vetë kandidatëve, ajo e përforcon këtë strukturë. E zhvendos fokusin nga përgjegjësia politike tek estetika familjare. Dhe kjo ka pasoja. Sepse mesazhi që përcillet është i qartë: edhe kur nuk garon për pushtet, do të gjykoheh për mënyrën si e zbukuron atë. Ndoshta është koha të ndryshojmë pyetjen. Jo: si duken gratë e politikanëve? Por: si i trajtojmë ato si profesioniste? Si i afirmojnë partnerët e tyre si profesioniste? Si i percepton publiku kur ato kërkojnë hapësirë të vetën?

Sepse në momentin që grua ja reduktohet në aksesori, pushteti mbetet pronë ekzekutive e burrave. Dhe në momentin që ajo njihet si zë më vete, me profesion, me bindje, me identitet të pavarur, politika bëhet më e barabartë. Në fund, çështja nuk është estetike. Është thellësisht politike.

Autorja është aktiviste feministe.

Kur kujdesi bëhet strategji



Hristina Cvetinčanin Knežević

Kujdesi rrallë bën bujë, por dhuna po

Pas 15 marsit 2025, nuk e trajtova më si një vëzhgim abstrakt. Atë ditë, gjatë protestave masive në Beograd pas shembjes së strehës së një stacioni hekurudhor që vrau njerëz të pafajshëm, një pajisje sonike u përdor kundër demonstruesve. Kjo ndodhi gjatë një heshtjeje 15 minutëshe. Asnjë brohoritje, asnjë slogan, vetëm heshtje, fëmijë, të moshuar, shoqja ime me një bateri zemre dhe pastaj zhurma. E menjëhershme, çorientuese dhe fizikisht pushtuese.

Deri më sot, nuk ka pasur asnjë konfirmim zyrtar për atë që është përdorur. Ajo që dimë është se si ndihej në trup atë tanë. Gjithashtu dimë se kush qëndronte në rreshtat e parë - gra, si gjithmonë, gazetare, studente, profesoresha, aktiviste, nëna. Ajo ditë bëri brutalisht të qartë diçka: edhe zia në publik mund të trajtohet si kërcënim për sigurinë.

Disa ditë më vonë, kolegja dhe shoqja ime e vjetër Milica Batricević organizoni një thirrje në Zoom. U bashkuan rreth njëzet gra. Qytete të ndryshme. Gjenerata të ndryshme. Drejttime të ndryshme të punës feministe. Nuk ishte një takim strategjik. Ishte një takim për t'u informuar mbi ecurinë.

*"A je e sigurt?"
"Si po mbahesh?"
"Kujti i duhet mbështetje?"*

Dhe pastaj ndodhi diçka e njohur: Kujdesi u shndërrua në analizë, sepse kur gratë dëgjojnë njëra-tjetrën, personalja në mënyrë të pashmangshme bëhet politike.

*Çfarë do të thotë kur shteti përdor tin-gullin si forcë?
Pse gratë janë vazhdimisht në vijën e parë?
Çfarë modelesh po shfaqen?
Dhe si reagojmë para përshkallëzimit të radhës?
Më e rëndësishmja: si durojmë?*

Atë pasdite ndjeva, jo vetëm që kuptova, diçka të cilën intelektualisht e kisha besuar prej kohësh - kujdesi feminist nuk është butësi. Është infrastrukturë dhe është ajo që e parandalon izolimin kur rritet trysnia.

Brenda disa javësh, ai rreth filloi të evoluonte. Jo në një projekt, jo në krijim marke, por në një sistem. Përsheptimi erdhi në fund të prillit, kur Dejan Vuk Stanković u emërua Ministër i Arsimit pavarësisht dëshmimeve publike nga studentet që e akuzonin për ngacmim seksual. Mesazhi ishte i pagabueshëm: të drejtat e grave ishin përsëri dëme anësore. Reagimet e fragmentuara nuk ishin më të mjaftueshme, kishim nevojë për sinkronizim.

Më 9 maj lindi Qendra Digjitale Feministe e Sinkronizuar, jo nga ambicia, por nga nevoja. Gjatë vitit 2025, ajo që filloi si një rreth emergjence u shndërrua në një ekosistem - hapësirë e përbashkët digjitale, një hapësirë ku mesazhet ishin të harmonizuara, njohuritë shkëmbeheshin dhe përgjigjet ishin të koordinuara. Kujdesi u bë funksional.

Kur një aktiviste e re, Nikolina Sindelić, dëshmoi publikisht për dhunën fizike dhe kërcënimet për përdhunim që i pësoi nga një zyrtar i lartë i policisë, Marko Kričak, dhe fotografitë intime nga kur ishte e mitur u përdorën kundër saj në një përpjekje për ta diskredituar dhe frikësuar; mobilizimi zgjati orë të tëra, jo ditë. Udhëzimet ligjore qarkulluan menjëherë, mesazhet u unifikuan, veprimet e koordinuara të raportimit masiv synuan llogaritë që shpëmdanin materialin, dhe paraqitjet në media u përzgjedhën dhe u harmonizuan me kujdes. Qëllimi nuk ishte vetëm të mbrohej një grua, por të parandalohesh izolimi. Izolimi është fitorja e parë e dhunës politike.

Kur Presidenti i Serbisë e vuri publikisht në dyshim besueshmërinë e saj në një letër drejtuar Presidentes së

Komisionit Evropian, pavarësisht provave të dokumentuara, përgjigja u koordinua përsëri. Taktikat manipuluese u analizuan, modelet e DARVO-s u përmendën hapur dhe gjuha që më parë kishte qarkulluar kryesisht në hapësirat feministe dhe të ekspertëve hyri në kanalet kryesore. Kujdesi nënkuptonte saktësi.

Në fund të korrikut, kur Serbia regjistroi vrasjen e 10-të dhe të 11-të të grave brenda 24 orëve, kurse përgjigjet institucionale u zhvendosën përsëri drejt fajësimit të grave, Qendra mbështeti një fushatë kundër asaj narrative: Këto nuk janë tragjedi. Ato janë femicid.

Në dekadën e fundit rreth 300 gra janë vrarë si pasojë e femicidit në Serbi, por nuk ka statistika zyrtare shtetërore. Të dhënat mbledhen nga organizatat e grave dhe nga raportet mediatike që shpesh sensacionalizohen, ose vonohen. Për më shumë se dhjetë vjet, organizatat feministe kanë kërkuar që femicidi të njihet ligjërisht si një krim i veçantë, por kërkesa është injoruar. Brenda një jave, fushata arriti mbi një milion llogari. Qëllimi nuk ishte vetëm ndërgjegjësimi, por ishte llogaridhënia. Femicidi nuk është fatkeqësi private, ai është dështim sistemik.

Në shtator u shpalos një krizë tjetër institucionale. Ministria e Drejtësisë propozoi ndryshime në Kodin Penal, duke përfshirë "marrëdhënien seksuale pa pëlqim" si një formë të zbutur të përdhunimit, duke ruajtur përkufizimin e vjetruar të përdhunimit të bazuar në forcë ose kërcënim, në vend të mungesës së pëlqimit. Organizatat e grave kishin kërkuar prej kohësh përkufizimin e bazuar në pëlqim, në përputhje me standardet ndërkombëtare, por në vend të kësaj propozimi rrezikonte t'i dobësonte mbrojtjet.

Qendra mbështeti avokimin e koordinuar, të udhëhequr nga Qendra e Grave Autonome. Qytetarët u nxitën të paraqisnin kundërshtime zyrtare gjatë konsultimit publik. Dy valë mobilizimi digjital e përforcuan çështjen në nivel kombëtar dhe transnacional. Shifrat ishin të zymta: mes 2021 dhe 2024, mesatarisht 77 përdhunime u raportuan çdo vit, megjithatë vetëm 85 dënime u siguruan në total gjatë asaj periudhe. Në mesin e tetorit, pas presionit të vazhdueshëm publik, propozimi u tërhoq.

Kujdesi, në këtë rast, nënkuptonte ndërhyrje legjislative.

Kishte edhe shembuj të tjerë. Një strateg marketingu i profilit të lartë që monetizonte mizogjininë dhe banalizonte dhunën ndaj grave nën maskën e humorit. Një deklaratë publike e koordinuar, raportim masiv, jo zemërim për hir të vetvetes, por llogaridhënie. Çështja u riformulua nga "përmbytje e ashpër" në dëm strukturor.

Qendra nuk funksionoi kurrë si autoritet i centralizuar, por si një muskul

i përbashkët. Feministet më të reja e kuptonin viralitetin digjital, aktivistet e vjetra mbartnin kujtesën institucionale, gazetarët siguronin saktësinë narrative, komedianet përkthenin analizën në një gjuhë të kuptueshme, dizajneret e shndërronin zemërimin në qartësi vizuale.

Kështu duket kujdesi kur bëhet strategji: koherencë në vend të fragmentimit, shpejtësi në vend të vonesës, zë kolektiv në vend të postimeve të shpëmdara, dhe në fund të vitit 2025, nisim mori Çmimin PRacka për Komunikim Kreativ, njohje jo për një fushatë të vetme, por për ndërtimin e një infrastrukture digjitale feministe të gjallë.

Në fillim të vitit 2026, ndërsa ciklet globale të medias transformuan publikimin e dokumenteve të lidhura me Epstein në spektakël të konsumueshëm, u bë e qartë se sa lehtë abuzimi sistemik mund të shndërrohet në argëtim. Viktimizimi sekondar dhe terciar u zhvillua në kohë reale përmes sensacionalizmit dhe spekulimeve.

Në të njëjtën kohë, në qytetin Kula, katërmëdhjetë gra të angazhuara publikisht u shënjestruan gjatë një fushate zgjedhore lokale me kërcënime për poshtërim dhe përmbytje intime të trilluar. Porosia ishte e qartë: hyr në politikë dhe trupi yt bëhet municion. Përgjigja ishte e menjëhershme - dënim publik, burime ligjore të përbashkëta, përforcim mediatik i koordinuar. Dimensioni politik u artikulua qartë: kjo nuk është thashetheme, kjo është dhunë politike me bazë gjinore.

Kur hapësirat publike bëhen të pasigurta dhe hapësirat digjitale bëhen arena frikësimi, kujdesi feminist duhet të evoluojë në arkitekturë, duhet të parashikojë izolimin dhe ta pengojë atë.

Qendra Digjitale Feministe nuk është platformë në kuptimin konvencional. Është një refleks, një protokoll i përbashkët dhe siguri që nëse një grua sulmohet në internet, dhjetëra të tjera do të reagojnë strategjikisht, jo në mënyrë kaotike. Ajo zvogëlon lodhjen përmes punës së përbashkët, ruan kujtesën duke dokumentuar strategji, mjete dhe mësimet për krizat e ardhshme.

Në kohë të paqëndrueshmërisë ekonomike, populizmit të krahut të djathtë, brishtësisë institucionale dhe përshpejtimit teknologjik, organizimi feminist nuk mund të mbështetet vetëm në spontanitet - ai kërkon infrastrukturë. Kujdesi, në këtë kontekst, nuk është lëshim emocional, është menaxhim i rrezikut, mbrojtje e narrativës, por edhe vazhdimësi ndër breza.

Kur rritet reagimi negativ, lëvizjet ose atomizohen, ose sinkronizohen. Ne zgjedhëm sinkronizimin, sepse e dimë që kujdesi feminist nuk është e kundërta e pushtetit, por mënyra se si pushteti mbijeton (!).

Autorja është sociologe dhe studiuese feministe.



Njeriu dhe Gruaja



Leila Arapi

Në shoqërinë tonë vërehet një fenomen kurioz. Në një situatë profesionale ku dominojnë gratë, burrat shpesh përmenden si minoritet edhe nga vetë gratë. Theksohet se si burri po duhet t'i durojë gratë, me deklaratat si: "Nuk po guxon me folë", "T'i kena prish nervat", "Shumë osht i mirë, na duron, s'na prish qejfin", ose: "Gjynah ka met me krejt gra, ja kena ça kryt". Këto deklaratat bëhen në formë shakaje, si një tentativë për të shprehur mirënjohje dhe për t'i akomoduar ata, duke treguar se jemi të vetëdijshme për parëhatinë e tyre në këtë situatë "jo-normale".

Kjo qasje ndryshon kur situata është e kundërt. Gratë në mjedise të dominuara nga burrat shpesh duhet të matin çdo fjalë: të mos duken "të buta", sepse shtypen, por as tepër të drejtëpërdrejta, sepse etiketohen si "emocionale". Akomodimet bëhen prapë nga gratë, për të ruajtur status quo-në e grupit dhe shpesh përfshijnë edhe të qeshura me shaka mizogjene për të mos u përkujtuar burrave se është një grua në mesin e tyre.

Herë pas here, i vetmi "akomodim" që bëhet nga burrat është shmangia e gjuhës vulgare në prani të asaj që e quajmë "gjinia e butë". Por, edhe kjo nuk e ndryshon dinamikën e grupit. Përkundrazi, e përforcon idenë se gruaja është dikush që duhet mbrojtur, jo një pjesëmarrëse e barabartë. Kjo asimetri është e dukshme edhe në mungesë të një njohjeje të sakrificave dhe rolit të grave kur ato janë minoritet brenda një grupi të dominuar nga burrat. Pritshmëria që gruaja të "përshtatet" mbetet standardi në të dyja situatat. Gratë janë shtesa që duhet të përshtaten me rregullat e vendosura nga të tjerët, jo pjesë e vetë standardit.

Përfashtimi i grave nga "standardi" ka prekur shkencat ekzakte dhe shoqërore. Studime më të mëdha të evolucionit historik dhe të antropologjisë e kanë privilegjuar gjuetinë si aktivitetin themelor që formësoi organizimin shoqëror dhe teknologjinë njerëzore, duke vendosur burrat si gjuetarë në qendër të tregimit. Por pyetja retorike: "Ku ishin gratë gjatë gjithë kësaj?" – është e rëndësishme. Roli i grave si mbledhëse (në anglisht: gatherers), kujdestare të fëmijëve dhe të sëmureve, baresha, rrobaqepëse, etj., përgjithësisht u minimizua si "prapavijë". Madje, hulumtimet e fundit tregojnë se ndarja e roleve nuk ka qenë gjithmonë strikte, por shpesh është përcaktuar nga eksperiencia dhe nevojat e grupit, jo nga një identitet i konstruktuar gjinor.

Në reflektimin filozofik ky përfashtim shfaqet tek koncepti i "tjetërsisë". Simone de Beauvoir, në librin e saj Seksi i dytë (në anglisht: The Second Sex), argumenton se gruaja pozicionohet si "Tjetra", jo për shkak të dallimeve biologjike, por si rezultat i një konstrukti patriarkal që i jep burrit pozicionin e subjektit dhe gruas rolin dytësor.

Pasojat janë konkrete. Shumë studime empirike dhe klinike janë kryer mbi mostra mashkullore, duke lënë jashtë eksperiencën femërore dhe duke përforcuar pabarazi bazike shëndetësore e socio-ekonomike. Po ashtu, formimi i institucioneve politike dhe ligjore, si dhe vetë nocioni i shtetit, nuk i ka pasqyruar nevojat e grave. Ndryshimet në formë të ligjeve të reja, shtesave, anekseve, erdhën me lëvizjet feministe, por shpesh u trajtuan si punë apo "shqetësim shtesë" për të akomoduar një standard që vazhdon të jetë i formuar nga perspektiva e burrave.

Kjo dinamikë reflektohet edhe në diskursin e përditshëm gjuhësor dhe në shembuj konkretë. Ne e përdorim fjalën "njeri" për t'iu referuar një bur-

ri, ndërsa për gratë përdoret "grua". Ajo nuk përfshihet automatikisht te "njeriu". Në dukje është çështje semantike, por në thelb është strukturë mendimi: "njeriu" paraqitet si kategori universale dhe neutrale, ndërsa në praktikë mishërohet me përvojën e burrave. Gruaja emërtohet veçmas, si përjashtim nga norma.

Këtu qëndron edhe tensioni i titullit "Njeriu dhe Gruaja". Vetë ndarja e këtyre termave zbulon hierarkinë që fshihet pas: "njeriu" si kategori e përgjithshme, "grua" si kategori e veçantë.

Edhe në praktikat gjuhësore perëndimore gjenden fenomene të tilla. Në gjuhën angleze, në ceremoni të kurorëzimit përdorej formulimi "Man and Wife", që do të thotë: "Burri dhe nuse, apo bashkëshorte". Identiteti i gruas shfaqet përmes lidhjes së saj me burrin, si bashkëshorte, nënë apo plotësuese e jetës së tij, ndërsa burri mbetet burrë, subjekt autonom me identitet të plotë në vetvete. Ky identitet mbetet i pandikuar nga relacioni i tij me një "nuse".

Në kontekstin kosovar, kjo tjetërsi ka pasojat të prekshme. Megjithëse gratë dominojnë në arsimin e lartë, kjo nuk përkthehet në përfaqësim në tregun e punës. Sipas një studimi nga 2023, 48% e grave janë në pozita fillestare, 47% në nivel të mesëm dhe vetëm 6% në pozita të larta. Nga 19 ministri, vetëm 5 udhëhiqen nga gratë. Këto pabarazi rrallë perceptohen si shqetësuese për qytetarin mesatar, sepse funksionojnë brenda një normaliteti të formësuar nga standardi patriarkal.


Kjo pabarazi strukturore gjen shprehje edhe në mënyrën se si shoqëria e feston dhe e interpreton figurën e gruas.

Gjithashtu shihet edhe në mënyrën si festohet 8 Marsi. Për shumëkënd trajtohet si "Dita e Nënës", ndërsa në thelb është ditë historike e luftës për të drejtat dhe barazi. Reduktimi i saj në festë simbolike e ngushton identitetin e gruas në rolin e nënës. Figura e nënës romantizohet si simbol i durimit, sakrificës dhe moralit familjar. Një nënë që mban "nderin e shtëpisë", që përballon padrejtësi në heshtje, që sakrifikon aspiratat personale për fëmijët dhe burrin, që toleron lodhje, mungesë vlerësimi, madje edhe abuzim, pa kërkuar hapësirën për vete. Ajo falënderohet për sakrificën, por rrallëherë vihet në pikëpyetje pse i është dashur të sakrifikojë kaq shumë. Romantizimi i kësaj figure e bën sakrificën e grave të duket si e natyrshme, si detyrë biologjike, e jo si rezultat i një rendi shoqëror që mbështetet në punën e saj të papaguar dhe të padukshme, si dhe në vuajtjen e heshtur të saj.

Pra, le të mos i romantizojmë gratë si martire perfekte të heshtura që po navigojnë këtë botë patriarkale. Problemi nuk qëndron vetëm në mungesë respekti individual, por në një strukturë më të thellë në të cilën burri trajtohet si masë universale, si standardi mbi të cilin ndërtohen grupet profesionale, shkencat, shteti, gjuha dhe vetë ideja se kush konsiderohet individi "normal" dhe autoritar në shoqëri. Kur universalja nënkupton burrin, gruaja duhet të emërtohet veçmas. Ajo duhet të përshtatet në grup, të luftojë për t'u përfshirë në histori, të kërkojë përfaqësim në institucione dhe shpesh të reduktohet në rolin e nënës së sakrifikuar. Në këto kushte kemi të bëjmë me shumë më tepër se me padrejtësi të rastësishme. Kemi të bëjmë me një rend shoqëror që e vendos gruan si shtesë ndaj asaj që paraqitet si neutrale apo standarde.

Prandaj sfida nuk është thjesht të "akomodohet" gruaja brenda standardit ekzistues, por të rishikohet vetë standardi. Sfida është të ndërtojmë një realitet ku gruaja është subjekt me identitet të plotë, pjesë e themelit të shoqërisë dhe vendimmartjes, jo një kategori e dytë që duhet të justifikojë vazhdimisht prezencën, zërin dhe nevojat e saj.

Autorja është hulumtuese dhe aktiviste për politika sociale.



Përkrahur nga:

